



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 324 Akti

Nr. 450 Vendimi
Tiranë, më 22.9.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 21.9.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Lorenc Mërkuri**, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Lorenc Mërkuri është subjekt rivlerësimi, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Lorenc Mërkuri i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 12.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Lulzim Hamitaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Lorenc Mërkuri; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 3.8.2021 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duke e njoftuar se afati për sjelljen e provave dhe shpjegimeve do të ishte deri më 23.8.2021. Subjekti ka kërkuar shtyrjen e afatit të caktuar nga Komisioni për sjelljen e provave dhe shpjegimeve, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, pas së cilës trupi gjykues ka vendosur shtyrjen e afatit për në datën 3.9.2021.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3 ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, në datën 21.9.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 21.9.2021, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre, për të vazhduar me shpalljen e vendimit në datën 22.9.2021.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. KONTROLLI I FIGURËS

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, ku mungonte informacioni nga një prej organeve ligjzbatuese. Pas administrimit të këtij informacioni, në vijim DSIK-ja ka përcjellë raportin tjetër të rishikuar me nr. *** prot., datë 19.12.2019, për subjektin e rivlerësimit Lorenc Mërkuri, i deklasifikuar pjesërisht.

10. Në këtë raport është konstatuar se, bazuar në informacionin e ardhur nga institucioni i verifikimit, rezulton se disponohen të dhëna nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptuese në disa çështje penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke informuar se:

- a) Ngrihen dyshime për veprime korruptuese në sistemin e drejtësisë. Në rastet e evidentuara të korrupsionit pasiv subjekti i rivlerësimit dyshohet të jetë përfshirë në korrupsion pasiv të prokurorit në disa procese penale.
- b) Ka dyshime të arsyeshme se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme, sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së tij. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.
- c) Informacioni që disponohet në ngarkim të prokurorit Lorenc Mërkuri, për implikim në veprimtari korruptuese të funksionarit të drejtësisë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose për të mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
- d) Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta nga prokurori me palën/personin në fazën e hetimit, apo gjykimit të një procedimi penal, është një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm, në shkelje të plotë të detyrës së tij funksionale.

11. Komisioni, duke u nisur nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion, dhe duke analizuar dosjet e procedimeve penale nr. 256, të vitit 2014 dhe procedimeve nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. *** të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

11.1 Lidhur me komponentin e figurës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të neneve Ç dhe DH, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, në referim dhe të dosjeve të analizuar nga Komisioni referuar më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

12. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës për këtë komponent, ka deklaruar se: *“Nuk e kuptoj pse nuk më jepet raporti i parë, ku ka qenë ndryshimi konkret, kush është autoriteti që mund të sqarojë kaq subjektivisht dhe cilat procedime konkrete (nëse ka të tjera). Për sa jam bërë me dije nga Komisioni, i kam dhënë sqarimet dhe provat e nevojshme. Në këto rrethana, duke qenë se është kryer rivlerësim nga Komisioni, jam bazuar në konstatimet që më paraqiten si konkrete, ku kam dhënë shpjegime dhe kam paraqitur prova”.*

13. Lidhur me pretendimin e subjektit për raportin e parë të figurës, është informuar që në barrën e provës së dërguar nga Komisioni se raporti fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, mungonte informacioni nga një prej organeve ligjzbatuese. Pas administrimit të këtij informacioni, në vijim është përcjellë nga DSIK-ja raporti tjetër i rishikuar, me nr. *** prot., datë 19.12.2019, për subjektin e rivlerësimit Lorenc Mërkuri, i deklasifikuar pjesërisht. Në këto rrethana, duke qenë se raporti përfundimtar është ai i deklasifikuar pjesërisht, i bërë me dije dhe subjektit të rivlerësimit, ishte ai mbi bazën e të cilit është kryer edhe rivlerësimi nga Komisioni, duke iu bërë me dije edhe konstatimet që iu paraqitën si raste konkrete, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova, analizuar si vijon. Komisioni, duke u nisur nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me paragrafin 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion, si dhe duke analizuar dosjet penale të referuara në raportin për kontrollin e

figurës, duke i dërguar subjektit barrën e provës, për sa ka rezultuar nga analizimi i dosjeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2014 dhe procedimeve nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nga analizimi i të cilave ka rezultuar se:

❖ **Procedimi penal nr. *****, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë

14. Komisariati i Policisë Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2014, ka referuar në këtë prokurori materialet për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 283 të Kodit Penal.

Sipas informacionit për referimin e veprës penale, në datën 28.4.2014, rreth orës 00:30, forcat e FNSH-së nr. *** Tiranë, në vendin e quajtur V., afër piramidës ***, në fshatin J., Sarandë, kanë gjetur të braktisura 4 çanta, me 137 pako, me peshë të përgjithshme 144,375 kg, të dyshuar me lëndë narkotike.

Sipas informacionit, transportin e kësaj lënde narkotike dyshohet se e bënte shtetasi B. H., i biri i shtetasit H. H., banues në fshatin N., Sarandë. Është bërë këqyrja, peshimi dhe sekuestrimi i lëndës së dyshuar si lëndë narkotike dhe mbi bazën e informacionit policia gjyqësore ka kërkuar shtetasin B. H. dhe ka bërë kontroll në banesën dhe stanin e babait të tij H. H..

Në banesë janë sekuestruar pesë telefona celularë, një kartë telefonike dhe një tytë arme gjahu, ndërsa në brendësi të rrethimit të bahçes, që ndodhej në territorin e stanit, janë gjetur dhe sekuestruar shtatë copë kallëpe lënde eksplozive, një ndezës granate, një kapsollë me fitil zjarri përcjellës 45 cm e gjatë, dy granata, një mbrojtëse dhe një mësymëse.

Policia gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit H. H. dhe materialet i ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 283 të Kodit Penal.

Mbi bazën e këtij materiali referues, subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 29.4.2014 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit H. H..

Po në datën 29.4.2014, shtetasi Ç. Sh., në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka vendosur veçimin e akteve nga procedimi penal nr. *** i vitit 2014, të referuara për dispozitën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, duke i regjistruar procedim më vete.

Në funksion të procedimit penal nr. ***, subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 30.4.2014, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me një kërkesë për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, me afat 30-ditor, sipas parashikimeve të nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale ndaj personin nën hetim H. H., për veprën penale të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, me argumentimin e nevojës për të kryer ekspertimet e nevojshme teknike dhe daktiloskopike për provat e sekuestruara.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. ***, datë 1.5.2014, sipas kërkesës së prokurorit, ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të shtetasit H. H. dhe ka caktuar për të si masë sigurimi “arrest në burg”, me afat 30-ditor, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Në datën 29.4.2014 subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur vleftësimin e sekuestros të bërë nga policia gjyqësore, si për lëndën e dyshuar si lëndë narkotike, të gjetur në 4 çanta, me peshë të përgjithshme 144,375 kg, të ndara në 137 pako, ashtu edhe për sendet e sekuestruara në banesë dhe në territorin e stanit, të cilat janë konsideruar se kanë cilësinë e provës materiale për çështjen.

Subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 5.5.2014 ka urdhëruar delegimin e veprimeve hetimore për oficerin e policisë gjyqësore që ka referuar aktet në prokurori, të cilat konsistojnë në verifikime që kanë lidhje vetëm me veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

Në datën 24.5.2014, mbi bazën e kërkesës së shtetasit H. H., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit për shtetasin H. H., nga “arrest në burg”, në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, sipas parashikimeve të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore të deleguara, në datën 22.12.2014 subjekti i rivlerësimit Lorenc Mërkuri, bazuar në germën “dh”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit H. H., me argumentin se nuk provohet se ka kryer veprën penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal.

Në datën 31.12.2014 subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 326, ka vendosur pezullimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, pasi autori i veprës penale nuk njihet.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës lidhur me këtë çështje, ka shpjeguar se: *“Kam vlerësuar materialin në kushtet që më është dhënë, nuk isha unë ai që urdhëroja kë pjesë të hetimit duhet të ndiqja, procedimi kishte ardhur i regjistruar, po ashtu emri i personit që i atribuohet vepra penale dhe cilësimi i saj. Arrestimi i personit nuk ishte kryer për veprën penale të narkotikeve, por për armëmbajtje pa leje. Dukej nga veprimet e para ka mbetur i veçuar materiali për pjesën e narkotikëve dhe mua më ka kaluar vetëm materiali për armëmbajtje. Vetëkuptohet që procedimi për narkotikët duhet të jetë nisur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk kam informacion më shumë për këtë çështje, pasi ka kaluar kohë e gjatë dhe drejtuesi i prokurorisë është larguar.*

Pavarësisht se është regjistruar procedimi për armëmbajtje, motivi duhet të ketë qenë hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për veprën e narkotikëve. Nga aktet kuptohet se procedimi për narkotikët ka pasur një ecuri më vite. Tek dosja ime nuk ka shumë material për narkotikët dhe të arrestuarin e kam pyetur për armëmbajtje. Sa i takon vendimit të pushimit jashtë afateve procedurale nuk më kujtohet duhet të jetë ndonjë lapsus sepse nuk ka pasur arsye që të jetë jashtë afateve”.

Subjekti ka depozituar: (i) vendim për veçimin e materialeve të çështjes penale nr. ***, (ii) urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë 29.4.2014; (iii) vendim për pushimin e çështjes, datë 16.6.2014; (iv) kopje e kopertinës së dosjes penale nr. *** datë 29.4.2014; (v) urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale; (vi) informacion datë 28.4.2014, për referim të veprës penale në prokurori; (vii) raport shërbimi nr. *** prot., datë 28.4.2014; (viii) procesverbal datë 28.4.2014, për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime; (ix) procesverbal datë 28.4.2014, për arrestimin në flagrancë; (x) vendim për pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, si dhe (xi) vendim për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit nën hetim.

Nga shqyrtimi i akteve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2014, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën

e konstatimeve të dërguara, duke mos dhënë shpjegime të drejta apo bindëse lidhur me këtë dosje penale, për sa i përket konstatimeve të Komisionit, sipas të cilave:

Së pari: vendimi për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit H. H. është marrë jashtë afatit ligjor. Ky shtetas është regjistruar si person nën hetim në datën 29.4.2014 dhe vendimi për pushimin e hetimeve ndaj tij është i datës 22.12.2014.

Referuar akteve të procedimit penal, pas afatit 3-mujor të hetimit, ndaj personin nën hetim H. H. nuk është vendosur asnjë zgjatje afati hetimi nga prokurori i çështjes Lorenc Mërkuri.

Trupi gjykues, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve, si dhe provave dhe shpjegimeve të subjektit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk është investuar në ndjekjen penale, nuk ka kryer veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes në ngarkim të shtetasit H. H. dhe nuk ka kërkuar zgjatje të afateve për hetimin e çështjes duke shkaktuar nga ana procedurale marrjen e një vendimi pushimi, jo vetëm tej afateve ligjore, por edhe pa kryer hetime të plota për rastin.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka vepruar nën dritën e përgjegjësive të tij si prokuror dhe detyrimit për të kryer veprime hetimore, të ushtrojë ndjekje penale, të drejtojë dhe kontrollojë hetimet paraprake, si dhe të kryejë vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit i kishte të gjitha rrethanat ligjore dhe provat për të vazhduar veprimet hetimore lidhur me procedimin penal “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me procedimin penal **“prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”** nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit, të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale¹.

Disponimi nga ana e subjektit të rivlerësimit me vendim për mosfillimin e procedimit penal, pasi nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se subjektit i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer hetim në mënyrë shteruese të rastit dhe për hetimin e plotë të çështjes, përpos problematikave të evidentuara për një vëzhgues të jashtëm krijon premisa serioze të cenimit të besimit të drejtësisë, në kontekstin e mosveprimit apo veprimeve të qëllimshme për të mos lejuar mbajtjen e përgjegjësive penale, duke krijuar efektin e pandëshkueshmërisë në perceptimin e publikut.

Së dyti: mbi bazën e informacionit për referimin e veprës penale, procedimi penal nr. *** duhet të ishte regjistruar për të dyja faktet e referuara, si për lëndën narkotike të sekuestruar, ashtu edhe për municionin, pasi fakti i gjetjes së lëndës narkotike dhe dyshimet se transportin e kësaj lënde narkotike e bënte shtetasi B. H., kanë passjellë dhe ligjëruar veprimet e policisë gjyqësore për kontrollin dhe sekuestrot në banesën dhe në stanin e shtetasit H. H..

Subjekti i rivlerësimit, në datën 29.4.2014, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur **vlerësimin e sekuestros të bërë nga policia gjyqësore, si për lëndën e dyshuar si lëndë narkotike, të gjetur në 4 çanta, me peshë të përgjithshme 144,375 kg, të ndara në 137 pako,** ashtu edhe për sendet e sekuestruara në banesë dhe në territorin e stanit, të cilat janë konsideruar se kanë cilësinë e provës materiale për çështjen.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të materialit të referuar nga policia gjyqësore, informacionit datë 28.4.2014, i cili për referimin e veprës penale tek prokurori, si

¹Funksionet e prokurorit, sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 2014: “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod”.

fakt penal kryesor mbi bazën e të cilit kanë filluar veprimet e para hetimore, **ka gjetjen dhe sekuestrimin e 4 çantave me 137 pako, me peshë 144,375 kg**, të dyshuar si lëndë narkotike.

Kjo sasi e dyshuar si lëndë narkotike është gjetur dhe sekuestruar pranë kufirit tokësor me shtetin grek dhe, në këto rrethana, vepra penale për të cilën duhet të fillohej procedimi penal “trafikim i narkotikëve”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, në kompetencë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duhej të transferohej nga subjekti pranë kësaj prokurorie.

Përderisa ka pasur një kallëzim penal nga policia gjyqësore, e cila ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit H. H. dhe materialet i ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 283 të Kodit Penal, pas ndarjes se procedimeve nga drejtuesi i prokurorisë, prokurori duhet të kishte dalë me vendim apo kërkesë edhe për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” dhe të përpilonte një akt procedural, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit, në kuadër të procedimit penal nr. ***, kishte vendosur vleftësimin si provë materiale për çështjen edhe të 4 çantave, me 144,375 kg lëndë të dyshuar si lëndë narkotike, nga policia gjyqësore e cila kishte bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit H. H..

Materialet ishin dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 283 të Kodit Penal. Ndarja e procedimeve nga drejtuesi passillte detyrimin e subjektit për transferimin e çështjes për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me procedimin penal “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale² i cili parashikon se, “*në rastet kur prokurori çmon se vepra penale është në kompetencë të një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente*”.

Mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë të dukshme dhe të tilla që çojnë në një vlerësim për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi ka munguar në marrjen e veprimeve procedurale të nevojshme dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të veprës penale

Për një vëzhgues të jashtëm krijon premisa serioze të cenimit të besimit të drejtësisë, në kontekstin e mosveprimit apo veprimeve të qëllimshme për të mos lejuar mbajtjen e përgjegjësisë penale, duke krijuar efektin e pandëshkueshmërisë në perceptimin e publikut.

❖ **Procedimi penal nr. *** (kallëzimi nr. ***, datë 26.5.2016)**

15. Mbi bazën e materialeve të referuara nga Stacioni i Policisë Livadhja, me shkresën nr. *** prot., datë 26.5(9, nuk kuptohet qartë) 2016, prokurori Lorenc Mërkuri, në datën 5.10.2016, ka urdhëruar:

- *Të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

- *Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, shtetasi J. V. S., i dyshuar se ka kryer veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

²Nëse gjatë hetimeve paraprake çmon se vepra penale është në kompetencë të një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente.

Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues, deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal, ka kaluar një periudhë prej rreth 4 muajsh.

❖ **Procedimi penal nr. *** (kallëzimi nr. ***, datë 1.6.2016)**

16. Mbi bazën e materialeve të referuara nga Komisariati i Policisë Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2016, prokurori Lorenc Mërkuri, në datën 6.10.2016 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si vijon:

- *Të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal.*

- *Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet personi i caktuar për mbajtjen e regjistrit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.*

Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues, deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal, ka kaluar një periudhë prej rreth 4 muajsh.

❖ **Procedimi penal nr. *** (kallëzimi nr. ***, datë 27.6.2016)**

17. Mbi bazën e materialeve të referuara nga Stacioni i Policisë Livadhja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2016, prokurori Lorenc Mërkuri, në datën 6.10.2016 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si vijon:

- *Të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal.*

- *Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personave nën hetim, shtetasve M. K. S. dhe G. V. S., të dyshuara secila prej tyre se kanë kryer veprën penale “dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal.*

Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues, deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal, ka kaluar një periudhë prej rreth 3 muajsh.

❖ **Procedimi penal nr. *** (kallëzimi nr. ***, datë 27.6.2016)**

18. Mbi bazën e materialeve të referuara nga Stacioni i Policisë Livadhja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2016, prokurori Lorenc Mërkuri, në datën 6.10.2016 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si vijon:

- *Të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

- *Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, shtetasi J. V. S., i dyshuar se ka kryer veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues, deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal, ka kaluar një periudhë prej rreth 3 muajsh.

❖ **Procedimi penal nr. *** (kallëzimi nr. ***, datë 30.6.2016)**

19. Mbi bazën e materialeve të referuara nga Stacioni i Policisë Livadhja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2016, prokurori Lorenc Mërkuri, në datën 6.10.2016 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si vijon:

- *Të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

- Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, shtetasit J. V. S., i dyshuar se ka kryer veprën penale “vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues, deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal, ka kaluar një periudhë prej rreth 3 muajsh.

Nga të dhënat e pasqyruara si më sipër, rezulton se urdhri për regjistrimin e procedimeve penale nr. ***, nr. ***, nr. ***, nr. *** dhe nr. *** të vitit 2016 është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

20. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës, ka deklaruar se: “Nga momenti i regjistrimit të materialeve kallëzuese deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të procedimit penal kalimi i afatit mbi një muaj nuk përbën shkelje të asnjë dispozite apo urdhri konkret; afatet janë për mosfillimet, që kanë pasur një afat të arsyeshëm dhe më vonë se 30 ditë, ndërsa Kodi i Procedurës Penale nuk ka pasur përcaktim konkret, tani e ka 15 ditë”.

21. Komisioni vlerëson se, referuar udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, është e përcaktuar qartë se brenda afatit 30-ditor prokurori duhet të kryejë vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë apo nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe duke përcaktuar se afati nuk është vetëm për mosfillimet, por është përgjithësues për çdo hetim të veprave penale.

22. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të mbështetura ligjërisht. Mosrespektimi i afateve kohore është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, që kanë qenë në fuqi në periudhën përkatëse.

23. Këto afate janë trajtuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i cili në pikën 2 të tij parashikon: “Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit.

24. Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar në pikën 2.1 të sipërpërmendur, **prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë.**

25. Gjatë periudhës 30-ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij udhëzimi, prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale”.

26. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal mbi bazën e materialeve të referuara në rastet e referuara me një afat prej rreth 3- 4 muaj më vonë, në se paku 3 raste konkrete ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin e sipërcituar të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka qenë i detyrueshëm për

zbatim, edhe asnjë qëndrim i shprehur nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të përbëjë justifikim dhe logjikë për moszbatimin e një detyrimi ligjor.

27. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në drejtim të verifikimeve të rezultateve të raportit të DSIK-së, lidhur me dosjet e analizuar rezultatet e hetimit të Komisionit në tërësinë e tyre mbështesin nxjerrjen e përfundimit nga Grupi i Punës së DSIK-së.

28. Në vlerësim të trupit gjykues mbahet edhe aksesimi nga ana e tij, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, për kontrollin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit, me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që shërbyen për arritjen e konkluzioneve paraqitur nga Grupi i Punës në raportin e DSIK-së.

29. Aksesimi i informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues dhe të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së dosja që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga SHISH-i për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

30. Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke, njohja me provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbart edhe kushtet specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror, trupi gjykues verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar edhe nga Grupi i Punës së DSIK-së, si dhe burimet e informacionit që kanë shërbyer për hartimin e raportit të këtij grupi.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

31. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, konstaton se nga faktet e analizuar nga Komisioni nuk rezultuan marrdhënie të tilla që të mund të kualifikohen në kuptim të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar person me kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por se konstatimet e gjetura gjatë hetimit, të rrethanave që përmbajnë praktikën e procedimeve penale, analizuar në funksion të këtij kriteri të vlerësimit kanë dëshmuar se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka krijuar kushtet e klimës së pandëshkueshmërisë në sytë e publikut, duke cënuar besimin e publikut te drejtësia, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I PASURISË

32. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarim të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

33. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore

për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

34. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore dhe atë të rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e subjektit Lorenc Mërkuri dhe personat e tjerë të lidhur, ka rezultuar si vijon:

1. Apartament banimi me sip. 69.30 m², në zonën *.**

35. Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë apartament banimi, me sip. 69.30 m², z. k. ***, në rrugën “****”, zona ***, Sarandë. Vlera e apartamentit është 3.118.500 lekë dhe pjesa takuese e personit të lidhur në këtë bashkëpronësi është 33.33 %. Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se është e përfshirë në bashkëpronësi të këtij apartamenti në 1/3 pjesë ideale me dy prindërit e saj, pa kontribut të vetin personal në blerjen e tij.

36. Burim krijimi për këtë pasuri në deklaratën *Vetting* janë deklaruar të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës së mëparshme në pronësi të prindërve të bashkëshortes së subjektit, K. dhe D. M., në datën 20.6.2007, në vlerën 2.000.000 lekë dhe të ardhurat e siguruar prej tyre në SHBA. Vlera e apartamentit është 3.118.500 lekë dhe pjesa takuese e personit të lidhur në këtë bashkëpronësi është 33.33 %.

37. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2012, në deklarimin e interesave pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme të personit të lidhur, bashkëshortja ka deklaruar pjesën takuese 33 % në apartamentin në pronësi të prindërve K. dhe D. M., zona ***, me vlerë 3.118.500 lekë, duke deklaruar se vlera totale për këtë apartament është paguar nga prindërit.

38. Referuar dokumentacionit, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së³, rezulton se praktika e kalimit të pronësisë së apartamentit të sipërpërmendur nga shoqëria “****” sh.p.k. në emër të blerësve K. e D. M. dhe E. M. është kryer nga kjo e fundit pranë zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.

39. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, pjesë e kësaj dosjeje, rezulton se sipërfaqja e plotë e këtij apartamenti ka qenë 100.8 m², prej të cilave sipërfaqe e përbashkët 5.9 m², sipërfaqe e ballkoneve 25.6 m² dhe sipërfaqe e shfrytëzimit 69.3 m².

40. Referuar Udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2011”, vlera mesatare e shitblerjes së apartamenteve për qytetin e Sarandës rezulton 52.096 lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi. Nëse në sipërfaqe të shfrytëzueshme do të ishin përfshirë edhe ballkonet, atëherë vlera e blerjes së këtij apartamenti duket shumë e vogël në krahasim me çmimet mesatare të tregut të shitblerjes së banesave në këtë vit në Sarandë.

41. Apartamenti nuk është pajisur me certifikatën e vërtetimit të pronësisë, por ka regjistrim provizor, datë 1.2.2011, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Rrethit Sarandë.

42. Sipas kontratës së shitblerjes, datë 19.1.2011, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse K. e D. M. dhe E. M. është blerë apartamenti nr. ***, kati i ***, me sip. 69.3 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në Sarandë, në vlerën 3.118.500 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

³F. 1004-1020.

43. Nga verifikimi në sistemin TIMS dukej se shtetasit K. dhe D. M., blerës të 2/3 të këtij apartamenti, nuk rezultojnë të kenë qenë në Shqipëri në datën 19.1.2011, datë e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

44. Gjithashtu, duket se edhe bashkëshortja e subjektit E. M., blerëse e 1/3 të kësaj pasurie, nuk rezultojnë të ketë qenë në Shqipëri në datën 19.1.2011.

Analizë e burimit të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie

45. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2012, në deklarin e interesave pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme të personit të lidhur (bashkëshortja) nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie nga prindërit e saj.

46. Bazuar në deklarin e personit të lidhur/bashkëshortja e subjektit në deklaratën *Vetting*, shuma për blerjen e këtij apartamenti e ka burimin nga të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës së mëparshme në pronësi të familjarëve të saj K. e D. M. dhe B. M., me kontratën nr. ***, datë 20.6.2007, në vlerën 2.000.000 dhe të ardhurat e tyre në SHBA.

Lidhur me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së subjektit nga shitja e apartamentit

47. Me kontratën e datës 20.6.2007, pala shitëse K. e D. M. dhe B. M. i ka shitur palës blerëse A. dhe B. Sh. apartamentin me sip. 73 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në Sarandë, në vlerën 2.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

48. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit, i pyetur mbi këto të ardhura, ka sqaruar se: “... bashkëshortja ime E. M. nuk ka pasur asnjë kontribut financiar të saj në blerjen e këtij apartamenti, pasi ai është blerë me të ardhurat nga shitja e apartamentit të parë, kursimet gjendje të prindërve të saj në kohën e blerjes, si dhe të ardhurat e siguruara nga puna e tyre në emigracion në SHBA. Arsyeja e përfshirjes së bashkëshortes sime në bashkëpronësi mbi këtë apartament ka qenë thjesht dëshira e prindërve të saj nisur nga qëllimi për të shmangur në të ardhmen veprime të kalimit të pronësisë mbi këtë pasuri. PAGESA PËR BLERJEN E APARTAMENTIT TË RI ËSHTË KRYER PJESË-PJESË NGA VITI 2007 E NË VIJIM, SIPAS FAZAVE TË AVANCIMIT TË PUNIMEVE NDËRTIMORE NGA SUBJEKTI NDËRTUES, NË RASTE TË CAKTUARA NGA VETË VJEHRRIM GJATË KOHËS QË KA ARDHUR NË SHQIPËRI DHE NË RASTE TË TJERA NGA BASHKËSHORTJA IME E CILA KISHTE DËRDHUR NË LLOGARINË E SAJ PRANË ‘ProCredit Bank’ NJË PJESË TË KURSIMEVE TË PRINDËRVE NËR VITE, SI DHE TË ARDHURAT E BURUARA NGA SHITJA E APARTAMENTIT TË VJETËR.

*Transaksioni i kryer me përfaqësuesin e shoqërisë ‘***’ sh.p.k. z. M. N., për aq sa kujton bashkëshortja ime E. M., është kryer sipas ligjit dhe zakonisht, me pagesa periodike.*

*Sqaroj se shuma e përfituar nga shitja e apartamentit të vjetër në masën 2.000.000 lekë, si dhe një pjesë e kursimeve gjendje të bashkëshortes, janë konvertuar në euro dhe totali i tyre në masën 20.000 euro janë derdhur në datën 20.6.2007 (pikërisht ditën e shitjes së apartamentit të vjetër) në llogarinë nr. *** të bashkëshortes time pranë ‘ProCredit Bank’, dega Sarandë”.*

49. Referuar hetimit administrativ nga OTP Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2020, ka rezultuar se në llogarinë në euro në emër të E. M./D. M. në datën 24.1.2011 është maturuar depozita në vlerë 3.107 euro dhe në të njëjtën ditë është tërhequr nga znj. E. M. shuma 3.000 euro. Në datën 19.1.2011 në këtë llogari ka pasur gjendje 4.013 euro, të cilat nuk janë tërhequr deri në datën 24.1.2011.

50. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në datën 19.1.2011, në shumën 3.118.500 lekë, për më tepër që nuk janë prekur edhe vlerat

monetare në llogarinë e përbashkët në euro në emër të shtetaseve E. M. ose D. M. në “Societe Generale Albania Bank”.

51. Faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje, provojnë: (i) se ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me apartamentin për shkak të pronësisë prej 1/3 pjesë nga bashkëshortja e tij; (ii) faktin që nuk provohet deklarimi i subjektit mbi burimet financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti për një shumë të konsiderueshme; (iii) marrëdhënien e vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit me këtë apartament, të cilët jetojnë prej vitesh në SHBA, gjë që nuk të krijon bindjen se janë pronarët *de facto* të këtij apartamenti; (iv) faktin që rezultoi nga verifikimi në sistemin *TIMS* se shtetasit K. dhe D. M. nuk rezultojnë të kenë qenë në Shqipëri në datën 19.1.2011, datë e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, dhe as bashkëshortja E. M. nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datën 19.1.2011 për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

52. Në analizë të fakteve dhe rrethanave referuara më lart, në këndvështrim të një sërë rrethanash të cilat kanë rezultuar nga hetimi që nuk mund të injorohen e të konsiderohen si joekzistente, në kushtet kur burojnë nga burime të njohura të provës, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 32 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të çmuara në raport me njëra-tjetrën, duket se çojnë në konkluzionin se subjekti është përpjekur të fshehtë pronësinë mbi këtë pasuri.

53. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

- i. subjekti është përpjekur të fshehtë këtë pasuri;
- ii. ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie;
- iii. me veprimet e mosveprimet e kryera ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

54. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: *“Të gjitha kontaktet me shitësin i ka realizuar vetë ai, si në Shqipëri ashtu edhe në SHBA, kjo për faktin se përfaqësuesi M. N. i subjektit shitës ‘***’ sh.p.k. dhe vjehrrin im kanë pasur njohje të hershme.*

Nuk mund të kujtoj për prindërit e bashkëshortes, por as nuk mund ta mendoj që ne apo noteri të bëjmë veprime të tilla dhe nuk kishte arsye pse të ndodhte. Pagesat janë bërë gradualisht, si në fakt ndodhte në gjithë praktikën në Shqipëri, bashkë me kursimet (kanë qenë në punë, kam deklaruar të ardhurat e tyre) dhe vlerën e shitjes, prindërit e bashkëshortes siguruan 20.000 euro që kaluan gradualisht tek shitësi M. N..

Pagesat cash lejoheshin nga ligji, për më tepër janë bërë me këste dhe nuk mund të shkonin në vlera të mëdha apo tej atyre që duhet të deklarohen në kufi. Palët nuk kanë pasur pretendime. Duke qenë me prokurë, disa veprime janë bërë nga bashkëshortja ime, të cilat ua kam paraqitur vetë shitësi, ka paraqitur deklaratën noteriale dhe kërkoj të pyetet dëshmitari.

Mosprekja e një llogarie të përbashkët në datën e blerjes, siç pretendohet, nuk nënkupton patjetër se çdo para në qarkullim nga prindërit e bashkëshortes shkon pikërisht për blerjen e banesës. Aq më tepër nuk shkelet ndonjë ligj apo rregull nëse një pjesë parash investohet më vonë (ditë tjetër, moment tjetër etj.). Prindërit e bashkëshortes janë të moshuar dhe është në të drejtën e tyre që ta mbyllin jetën në Shqipëri, ata nuk kanë blerë akoma dhe sot pasuri të paluajtshme në SHBA dhe kanë vetëm një automjet, jetojnë gjithë kohën me qira”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

55. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore, arsyetohet se:

- Dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë në pronësi dhe burimet e krijimit të tyre në momentin e krijimit të saj.

56. Trupi gjykues vlerëson se pronësia e bashkëshortes së subjektit, të pjesës prej 1/3 në këtë apartament, passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

57. Në kontekst të procesit të rivlerësimit, analiza e të dhënave mbi këtë pasuri, për shkak të hetimit administrativ, realizohet në kontekst dhe funksion të këtij procesi, e individualizuar sipas fakteve të këtij rasti në vijim.

58. Marrëdhënia e prindërve të bashkëshortes së subjektit me këtë apartament nuk krijon bindjen se ata janë pronarët *de facto* të tij, duke pasur parasysh se nuk ishin prezentë në ditën e nënshkrimit të kontratës për këtë pasuri.

59. Subjekti i rivlerësimit, i ngarkuar me barrën e provës për të provuar prezencën e bashkëshortes dhe prindërve të saj në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti, paraqiti shpjegime dhe prova vetëm për prezencën e bashkëshortes ditën e nënshkrimit të kontratës dhe nuk paraqiti asnjë shpjegim prove apo dokumentacion ligjor provues për prezencën e prindërve të saj, të cilët, sipas deklaratimeve të subjektit ishin ata që e kishin krijuar me të ardhurat e tyre këtë pasuri në ditën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, duke mos provuar deklaratimin e tij se prindërit ishin ata që e kishin realizuar blerjen e këtij apartamenti.

60. Nga sistemi *TIMS* rezultoi e provuar dhe e pakontestuar nga subjekti i rivlerësimit fakti se prindërit e bashkëshortes nuk kanë qenë prezentë në ditën e nënshkrimit të kontratës, pasi rezultoi që ata kanë dalë nga territori shqiptar në datën 19.5.2010 dhe kanë rihyrë në datën 18.11.2011, duke rezultuar të mos kenë qenë për një periudhë disamujore para dhe pas kontratës se nënshkruar prej tyre për blerjen e kësaj pasurie para noterit publik.

61. Referuar deklaratimeve të subjektit në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur në datën 12.4.2016 subjekti i rivlerësimit, i pyetur në pyetjen nr. 5 lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur/bashkëshortja dhe prindërit e saj ka deklaruar si burim të ardhurat që prindërit e bashkëshortes dhe motra e saj kanë përfituar nga shitja e banesës së tyre të përfituar nga privatizimi.

62. Lidhur me burimin e deklaruar të krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së tyre të përfituar nga privatizimi në pronësi të shtetasve K. e D. M. dhe B. M., me kontratën nr. ***, datë 20.6.2007, ishin në vlerën 2.000.000 lekë.

63. Nga hetimi rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka kryer derdhje në llogarinë e saj në datën 20.6.2007, në vlerën 20.000 euro, e cila u deklarua si burim për të ardhurat nga shitja e apartamentit të prindërve të saj (apartament i cili u shit në vlerën 2.000.000 lekë). Kjo shumë monetare është tërhequr një ditë më vonë nga bashkëshortja dhe, në vijim, pas ridedepozitimit në datën 30.4.2008, prej saj u transferua në llogarinë e të birit vlera 14.803,35 euro.

64. Shtetas J. I. i është transferuar vlera 7.500 euro nga llogaria e djalit të subjektit, ndërsa vlera 7.200 euro është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datat 29.5.2008 dhe 13.6.2008.

dhe në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes me nënën e saj, në datën 31.3.2010 u depozitua vlera 6.500 euro, nga të cilat, në datën 19.1.2011 në këtë llogari ka pasur gjendje 4.013 euro, të cilat nuk janë tërhequr deri më 24.1.2011.

65. Nga vlerësimi i situatës faktike financiare dhe analizimi i mësipërm i transaksioneve bankare të bashkëshortes, trupi gjykues vlerëson se referuar fakteve të sipërcituara nuk provohet që të ardhurat nga shitblerja e mësipërme e pronës së paluajtshme nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të jenë përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie.

66. Pas rezultateve të hetimit, kur subjektit iu njoftua se nuk janë prekur vlerat monetare të mbetura në llogarinë e përbashkët në euro në emër të shtetaseve E. M. ose D. M. në “Societe Generale Albania Bank”, ai deklaroi se si burim kishin shërbyer të ardhurat e përfituara nga këta shtetas nga punësimi i tyre në SHBA.

67. Njohur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shtuar burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortes për blerjen e apartamentit në datën 19.1.2011, duke shtuar edhe kursimet gjendje të tyre dhe duke deklaruar se pagesa për blerjen e këtij apartamenti është kryer pjesë-pjesë nga viti 2007 e në vijim.

68. Deklarimi se pagesa për blerjen e këtij apartamenti është kryer pjesë-pjesë nga viti 2007 e në vijim, nuk është justifikuar me asnjë dokumentacion ligjor provues, i cili të vërtetojë se ka pasur një marrëdhënie të mëparshme të prindërve të bashkëshortes së subjektit me shoqërinë e ndërtimit apo të vërtetojë kohën dhe shumën e paguar për shoqërinë e ndërtimit ndër vite.

69. Referuar shpjegimeve pas rezultateve të hetimit, *vjehri K. M., të gjitha kontaktet me shitësin i ka realizuar vetë si në Shqipëri, ashtu edhe në SHBA, për faktin se përfaqësuesi M. N., i subjektit shitës “***” sh.p.k. dhe vjehri kanë pasur njohje të hershme.*

70. Njohur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shtuar burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortes për blerjen e apartamentit në datën 19.1.2011, duke shtuar edhe kursimet gjendje të prindërve të saj dhe duke deklaruar se pagesa për blerjen e këtij apartamenti është kryer pjesë-pjesë nga viti 2007 e në vijim, por nuk është justifikuar me dokumentacion ligjor koha dhe shumën e paguar.

71. Për sa i përket të ardhurave nga punësimi në SHBA të prindërve të bashkëshortes, nga të dhënat e depozituara nuk ka asnjë dokumentacion i cili të këtë arritur të provojë transferimin e këtyre shumave nga SHBA-ja nëpërmjet rrugës bankare apo tokësore, për sa në dy hyrjet e prindërve të bashkëshortes së subjektit nuk është deklaruar në kufi transportimi i vlerave monetare, të cilat, referuar çmimit të shitblerjes dhe numrit të hyrjeve të tyre në vitet 2008 dhe 2010, do të ishin mbi vlerën e detyrueshme për deklarim gjatë hyrjes në aeroportin e Rinasit, për të provuar destinacionin dhe mbërritjen e tyre në Shqipëri.

Lidhur me deklarinë e subjektit se vjehri K. M., të gjitha kontaktet me shitësin i ka realizuar vetë si në Shqipëri, ashtu edhe në SHBA, për faktin se njëhej me përfaqësuesin M. N., e subjektit shitës “” sh.p.k.***

72. Nga verifikimi në QKB ka rezultuar se shoqëria “***” sh.p.k. është themeluar nga ortakët L. dhe M. N., të cilët më 21.1.2009 i sheshin aksionet në masën 100%, për vlerën e tyre nominale prej 100.000 lekësh shtetases M. Z., e cila dy javë më vonë, në datën 9.2.2009 ia shet aksionet për vlerën e tyre nominale shtetasit V. Ll. Në datën 6.10.2010 u lëshua prokura e përgjithshme nga shtetasi V. Ll. për shtetasin M. N..

73. Para vitit 2011 (vit i lidhjes së kontratës) në udhëtimet e shtetasit M. N., i cili rezultoi të ketë udhëtuar me linja ajrore midis datave 21.1.2009, datë kur i kishte shitur kuotat e shoqërisë, dhe para datës 6.10.2010, kur u lëshua prokura e përgjithshme nga shtetasi V. Ll. për të, kohë

kur ishte në fuqi legjislacioni për shoqëritë tregtare, shtetasi M. N. nuk kishte asnjë tagër ligjor në shoqëri dhe nuk mund të ketë vepruar në emër e për llogari të shoqërisë.

74. Komisioni arsyeton se deklarata noteriale e shtetasit M. N. merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratës noteriale forcohet sidomos pasi nuk mbështetet dhe nuk është në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, referuar më sipër.

75. Deklarata noteriale rezulton se daton pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbetet në nivelin deklarativ. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi të panevojshëm thirrjen dëshmitar të këtij shtetasi, bazuar në pikën 6/a, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

76. Në këtë situatë, trupi gjykues vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke zgjedhur të mos jetë i sigurtë në shpjegimet mbi gjendjen e pasurisë që bashkëshortja e tij disponon në 1/3 pjesën, përbën një rrethanë që më së pakti, në këndvështrimin e një vëzhguesi objektiv, përbën arsye që të cenohet besimi i publikut te drejtësia, në kushtet kur individi dhe funksioni me të cilin ai shoqërohet ndërthuren në mënyrë të pandarë.

77. Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë arsyen se përse u hartua dhe u nënshkrua kontrata në emër të prindërve të bashkëshortes së saj, për 2/3 pjesë të pasurisë, kur nuk ishin prezentë në Shqipëri, dhe nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të tij, përpjekja e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, që lidheshin me krijimin e kësaj pasurie, në vlerësimin e trupit gjykues bëjnë që të ndodhet në kushtet pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjet tip “Audi”, me targa ***

78. Në deklaratën *Vetting* subjekti rivlerësues ka deklaruar në pronësi të tij automjetin tip “Audi”, me, të regjistruar në DRSHTRR-në Sarandë. Automjeti është blerë me kontratën datë 21.2.2015, nga shoqëria “****” sh.p.k. me faturën tatimore të shitjes nr. ***, datë 21.2.2015. Vlera e automjetit është 1.020.216 lekë dhe rezulton 100% në pronësi të subjektit rivlerësues.

79. Burimi i krijimit i përshkruar në deklaratën *Vetting* vjen nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “Mercedes-Benz” me targa ***, me kontratë nr. ***, datë 15.1.2015, me çmimin 500.000 lekë, si dhe nga vlera prej 400.000 lekësh e dhuruar nga janari i vitit 2015 nga vjehri i subjektit rivlerësues K. M. (deklaruar dhurimi me deklaratën datë 15.11.2016), ndërsa diferencën prej 120.216 lekësh me kontributin e subjektit rivlerësues nga kursimet prej pagës.

80. Nga analizimi i burimeve të krijimit referuar burimit të parë, automjetit të mëparshëm tip “Mercedes-Benz” ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes datë 15.1.2015, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit A. A. automjetin tip “Daimler Chrysler E 220 CDI”, kundrejt çmimit 500.000 lekë, shumë e likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

Kronologjia e blerjes dhe shitjes së këtij automjeti

81. Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI, datë 5.10.2012, subjekti rivlerësues, në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyrokastër, ka deklaruar lidhur me automjetin “Mercedes-Benz E 220 CDI”, me targa ***, prodhim i vitit 2003, se është blerë me huan bankare në shumën 10.000 euro, të akorduar nga dega “Societe Generale Bank” dega Sarandë, në vitin 2010. Në llogarinë në euro, në emër të znj. E. M., datë 22.5.2009, është disbursuar kredia në shumën 10.000 euro. Në të njëjtën ditë është tërhequr *cash* shuma 10.000 euro.

82. Referuar të dhënave nga DPSHTRR-ja është konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin e regjistruar me targa ***, duke dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti, konkretisht: (i) leje e qarkullimit rrugor të automjetit me targa ***, datë 25.2.2010; (ii) kartelë automjeti model *** dhe certifikatë e kontrollit fizik model ***, datë 24.2.2010; (iii) dokument hyrjeje, leje qarkullimi provizore nr. *** prot., datë 22.2.2010, e Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, stacioni PKM Kakavijë; (iv) deklaratë doganore *** me nr. ***, datë 22.2.2010; (v) mandatpagesë të detyrimeve doganore në “Tirana Bank”, në datën 22.2.2010, në shumën 358.583 lekë; (vi) faturë nr. ***, datë 6.2.2010, nga shoqëria “****”, Munchen, Gjermani për blerjen nga subjekti të automjetit tip “Mercedes-Benz E220CDI Elegance”, kundrejt shumës 6.000 euro; (vii) leje qarkullimi automjeti tip ***, regjistruar në emër të shtetasit Lorenc Mërkuri, në Munchen, më 7.5.2009, me vlefshmëri deri më 21.5.2009.

83. Referuar të dhënave nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti ka hyrë në territorin shqiptar me automjetin me targa ***, në datën 9.5.2009, në orën 15:45, nëpërmjet pikës doganore Qafë-Botë. Pa regjistruar dalje në pikat doganore shqiptare, subjekti, bashkë me automjetin e sipërpërmendur me targa ***, ka hyrë sërish në territorin shqiptar në datën 22.2.2010, në orën 13:24, nëpërmjet pikës kufitare Kakavijë.

84. Nga dega e Doganës Kakavijë⁴ është vënë në dispozicion praktika e zhdoganimit ***, ***, datë 22.2.2010, për këtë automjet. Në këtë praktikë mungon vërtetimi i hyrjes për këtë automjet, gjithashtu, bashkëlidhur është edhe leja e qarkullimit për targën ***, regjistruar në emër të subjektit në datën 7.5.2009, me vlefshmëri deri më 21.5.2009, ndërsa në procedurat e zhdoganimit është kryer në datën 22.2.2010, në bazë të faturës nr. ***, datë 6.2.2010, nga shoqëria “****”, Munchen, Gjermani.

85. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur lidhur me kohën e saktë dhe çmimin real të blerjes së këtij automjeti, duke dokumentuar edhe burimin e të ardhurave të këtij çmimi në momentin e blerjes, shpjegon: *“Automjeti në fjalë është blerë në Mynih të Gjermanisë, në datën 6.5.2009, kundrejt çmimit 6.000 euro. Burimi i të ardhurave në momentin e blerjes ka qenë shuma prej 8.000 euro e marrë hua përpara nisjes për në Gjermani në datën 3.5.2009, nga i afërmi im T. M., me të cilin kemi udhëtuar së bashku si në vajtje në Gjermani ashtu edhe në kthim në Shqipëri, duke qenë se edhe ai ishte i interesuar dhe kreu blerjen e një automjeti për veten e tij (bashkëlidhur deklarata not. e shtetasit T. M. datë 5.7.2021). Destinacioni i shumës prej 10.000 euro, të huas së marrë në Bankën Popullore, tërhequr cash në datën 22.5.2009, ka qenë pikërisht në funksion të blerjes së automjetit, pasi nga kjo shumë vlera prej 8.000 euro i është kthyer cash shtetasit T. M., në datën 23.5.2009, ndërsa pjesa e mbetur prej 4.000 euro ka shërbyer për zhdoganimin, regjistrimin, si dhe shpenzimet e udhëtimit gjatë periudhës 9.5.2009 - 2.2.2010, automjeti nuk është përdorur ...”*

86. Nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore është deklaruar se huaja bankare në shumën 10.000 euro, marrë në bankën “Societe Generale Albania”, shërben si burim për blerjen e kësaj pasurie.

87. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni rezulton se huaja është disbursuar dhe tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit në datën 22.5.2009, më prapa në kohë ndaj nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 7.5.2009.

88. Në lidhje me pretendimet e subjektit⁵ për huan e marrë nga i afërmi T. M., në datën 3.5.2009, në shumën 8.000 euro, si burim për blerjen e këtij automjeti, referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, kjo hua nuk është deklaruar asnjëherë nga

⁴Shkresë kthim përgjigje nr.*** prot., datë 5.7.2021.

⁵Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

subjekti dhe /ose personat e lidhur as në deklaratimet periodike vjetore, as në deklaratën *Vetting* dhe as në përgjigje të pyetësorëve paraardhës, si dhe nuk mbështet në dokumentacionin provues në kohën e dhënies së saj.

89. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

i) Subjekti ka kryer deklaratim të rremë në deklaratën *Vetting* lidhur me këtë pasuri, si dhe ka ndryshuar burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në datën 7.5.2009.

ii) Subjekti nuk ka arritur të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

iii) Me veprimet dhe mosveprimet e kryera ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

90. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka parashtruar: *“Gjatë procedurave të shumta më ka humbur dokumenti i shitjes dhe jam detyruar të kërkoj dublikatë, e cila më ka ardhur vetëm pas kaq kohësh dhe me datën e lëshimit të dublikatës. Dublikata nuk ka asnjë ndryshim në të dhënat dhe vlerën. E kisha të pamundur pa dublikatën ose faturën e blerjes të kryeja zhdoganimin. Plus nuk mund dhe nuk dëshiroja aspak të shkelja rregullat.*

Është zhdoganuar në kohën më të shpejtë të mundur mjeti, pasi kisha tashmë kopje të dokumentit të shitjes. Nuk kam ndërhyrë në asnjë procedurë, ka vepruar dogana në mënyrë të pavarur. Kam bërë çdo pagesë të nevojshme që më është bërë prezent. Fatura në fakt ka qenë gjithnjë formalitet, besoj dhe atëherë, se kur vinte puna për doganën është proceduar gjithnjë me çmim reference, ndërsa si detyrim paguhej në atë kohë në mos gaboj vetëm TVSH-ja.

Regjistrimi i hyrjes në sistem, në datën 22.2.2010, mendoj duhet të jetë bërë për efekt formal zhdoganimi, pasi dogana kishte interes mbledhjen e vlerës doganore dhe ndoshta nuk procedohej dot në këto rrethana, ndërkohë unë këtu nuk shfaqem në asnjë lloj përfitimi”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

91. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

92. Në rastin konkret, fatura e blerjes e datës 6.2.2010 nuk ka asnjë lidhje kohore me marrjen dhe targimin në Gjermani të këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit (datë 7.5.2009). Subjekti nuk arriti të shpjegojë se si arriti të realizojë hyrjen e këtij automjeti në vitin 2009 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa kryer më parë zhdoganimin, dhe se si realizoi hyrjen rishtas të tij në territorin shqiptar në datën 22.2.2010, pa dokumentuar daljen e tij.

93. Kryerja e zhdoganimit të automjetit sikur të kishte hyrë në datën 22.2.2010, në territorin e Shqipërisë janë pasojë e veprimeve të mësipërme të kryera nga subjekti, të cilat janë kryer në shkelje të praktikave normale duke kryer procesin e regjistrimit të këtij automjeti, jo vetëm duke shmangur detyrimet doganore që lindin nga vonesat⁶ në zhdoganim, por edhe mbi paraqitjen e fakteve të pa vërteta nga ana e tij lidhur me zhdoganimin dhe duke mos paraqitur çmimin apo kohen reale të blerjes së këtij automjeti në vitin 2009.

94. Trupi gjykues vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit. Sjellja e subjektit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i

⁶Referuar deklaratës doganore ***, datë 22.2.2010, është llogaritur vetëm 1ditë qëndrimi (DQN).

publikut tek integriteti dhe autoriteti i ushtrimit të ndjekjes penale, përbën zgjedhje, të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë.

95. Pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, pasi rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të detyrës së tij, konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin apo edhe në formën e pranimin të veprimeve, të cilat dukshëm janë jo në përputhje me ligjin, cenojnë vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që subjekti duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

96. Pavarësisht këtij vlerësimi, trupi gjykues thekson se sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve të subjektit në deklaratat periodike dhe ato të rivlerësimit, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë saktësisht dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të.

97. Për rrjedhojë, duke qenë se në rastin konkret objekt shqyrtimi ishte deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, sa i përket kësaj pasurie nuk sjell asnjë pasojë në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, për shkak se ky deklarim për këtë automjet nuk është bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por do të vlerësohet në kuptim të vlerësimit tërësor për subjektin dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Apartament banimi me sip. 93 m², në Sarandë

98. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 93 m², në lagjen nr. ***, rruga “***”, p. ***, shk. ***, ap.***, Sarandë, me burim privatizimi, blerë nga Ndërmarrje Komunale, me kontratën nr. ***, datë 7.6.1993. Burimi i kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat nga pagat e prindërve, ku vlera është 25.157 lekë dhe pjesët takuese 100% në bashkëpronësi të prindërve të subjektit rivlerësues në këtë apartament.

99. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: shtesë banese me sip. 40 m²+trualli në bashkëpronësi me banorët e tjerë të seksionit të pallatit, në adresën: lagjja nr. ***, rruga “***”, p. ***, sh.***, ap. ***, kjo bazuar në vendimin nr. ***, datë 13.10.1998, të KRRT-së së Rrethit Sarandë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, sipas subjektit rivlerësues, është nga të ardhurat nga pagat e prindërve dhe më vonë edhe nga paga e tij, e motrës dhe e bashkëshortes së subjektit rivlerësues. Investim i kryer gradualisht ndër vite, aktualisht në procedurë për regjistrim: Godinë = 1.421.280 lekë + truall = 28.950 lekë = totali 1.450.230 lekë. Pjesa e tyre = 1.450.230:5 = 290.046 lekë. Pjesa takuese: 100% në bashkëpronësi të prindërve.

100. Në DIPP-në e vitit 2012, depozituar në ILDKPKI me datë 5.10.2012, lidhur me formularin A-1, “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, nuk rezulton e pasqyruar kjo pasuri e personave të lidhur të subjektit rivlerësues. Kjo pasuri, emërtuar “shtesë banese”, rezulton e deklaruar me datë 20.3.2004, nga personi i lidhur Th. M., duke qenë se ky i fundit ishte me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

101. Në DIPP-në e vitit 2004, personi i lidhur Th. M. ka deklaruar që vlera e shtesës është 1.000.000 lekë. Pjesa takuese 100% dhe krijimi i pasurisë është në vitet 1998 – 1999.

102. Lidhur me ndërtimin e shtesës rezulton të jetë lidhur kontratë ndërtimi me datë 15.5.1999, me palë ndërtuese shoqëria “***”, me administrues shtetasit A. C. dhe Th. M., me vleftë të punimeve të objektit në shumën prej 1.201.200 lekësh.

103. Pra, siç konstatohet, kemi tri vlera të ndryshme për këtë objekt, të pasqyruara në dokumentacionin përkatës: nga personi i lidhur Th. M. është 1.000.000 lekë në DIPP-në e vitit 2004, nga subjekti rivlerësues në deklaratën *Vetting* është 1.450.230 lekë dhe në kontratën me shoqërinë ndërtuese vlefte e punimeve rezulton 1.201.200 lekësh.

104. Subjektit iu kërkua të deklarojë dhe shpjegojë mospërputhjet e vlerave dhe në pyetësor deklaroi se vlera e saktë ishte ajo e kontratës së lidhur në vitin 1999.

105. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* lidhur me vlerën e këtij ndërtimi, për sa ka deklaruar një vlerë të ndryshme nga ajo e kontratës së vitit 1999.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

106. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: *“Në të njëjtën logjikë im atë ka paraqitur një parashikim. Në fund të fundit vlera reale mbetet ajo e fundit (në kohë mund të lëvizin çmimet, mund të këtë ndërhyrje sistemuere apo shtesa në pagesat e dokumentacionit, tatimeve etj.). Duke qenë se babai ishte subjekt dhe e kishte deklaruar, në interpretim logjik kam menduar se ishte e deklaruar dhe nuk mund të deklarohej dy herë, pa llogaritur problemet me procedurat në kohën, interpretimin dhe përcaktimet ligjore konfuze për kohën apo dhe mosndërhyrjen e pakuptueshme në kohë të ILDKPKI-së për saktësim, e detyrueshme sipas ligjit.*

*Në deklaratën *Vetting* që kam bërë (vlera 1.450.230 lekë) jam munduar të jem sa më realist pranë shumës reale të shpenzimeve dhe të mos harrojmë se vlera totale përfshin dhe shpenzime (regjistrim, rritje çmimesh, investime, ndryshime detyrimesh, etj.), për më tepër unë nuk jam profesionist i fushave dhe thjesht kam bërë përpjekjet maksimale për transparencë, ndryshe ligji nuk parashikonte saktësimet nga ILDKPKI-ja”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

107. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, përveç pasaktësive në deklarime, konstatohet të ketë mospërputhje lidhur me vlerën e krijimit të pasurisë, mospërputhje këto, të cilat evidentohen jo vetëm mes deklarimesh, por edhe mes akteve të administruara.

108. Kontrata përbën një akt juridik me fuqi të plotë provuese, e cila rezulton e lidhur rregullisht nga palët në prani të noterit publik, me vullnetin e tyre të plotë, duke u dakordësuar dhe nënshkruar.

109. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka reflektuar vlerën, kohën në deklaratën e pasurisë *Vetting* referuar kontratës dhe, për pasojë, subjekti nuk i mbështet pretendimet e tij në prova të besueshme dhe pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera.

110. Vlera e koston së ndërtimit rezulton e ndryshme në sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe babai në deklaratën fillestare si subjekt deklarues në vitin 2003, si dhe e ndryshme në dokumentacion. Të gjitha këto prova, të cilat plotësojnë kriteret e germës “a”, të pikës 1, të nenit 49 dhe pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nuk sjellin informacion mbi vlerën reale të koston së ndërtimit.

111. Në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, subjektet e rivlerësimit duhet të rezultojnë shterues në Komision me deklarimet e tyre, sidomos në deklaratën *Vetting*.

112. Në këto kushte, situata faktike, lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, klasifikohet sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Apartament banimi sip. 112 m² + zyrë me sip. 28 m² + truall me sip. 150 m², në Sarandë

113. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 112 m² + zyrë me sip. 28 m² + truall me sip. 150 m², në bashkëpronësi me avokatët, me vendndodhje në lagjen ***, rruga “****”, ***, Sarandë. Trualli është blerë nga shteti me kontratën nr. ***, datë 14.8.1996. Krijuar në vitet 1996 – 2015 dhe investuar periodikisht sipas mundësisë. Sipas subjektit rivlerësues, burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat familjare ndër vite.

114. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, depozituar në ILDKPKI me datë 5.10.2012, lidhur me formularin A-1, “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, nuk rezulton e pasqyruar kjo pasuri.

115. Kjo pasuri rezulton e pasqyruar në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në datën 16.3.2005, për personin e lidhur, Th. M., me subjektin e rivlerësimit.

116. Bazuar në dokumentacionin e pasqyruar në deklaratën *Vetting* dhe në ILDKPKI, konstatohet se me vendimin nr. ***, datë 9.3.1996, të Këshillit të Bashkisë Sarandë, bazuar në kërkesën e datës 1.2.1993, të pesë avokatëve, ku një prej tyre është edhe personi i lidhur Th. M., u jepet në bashkëpronësi një sipërfaqe prej 150 m².

117. Në datën 10.12.2002, midis shoqërisë ndërtuese “****” dhe grupit të avokatëve lidhet kontrata e ndërtimit për ndërtimin e objektit zyra+banesë.

118. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë, i sipërcituar, bazohet në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.8.1996, me palë shitëse Seksionin e Financës të Këshillit të Rrethit Sarandë, dhe blerës grupin e avokatëve kishte si objekt shitjen e një sipërfaqeje trualli në bashkëpronësi, me sip. 150 m², për ndërtimin e zyrave të avokatisë.

119. Ky objekt shitet përkundrejt vlerës 108.000 lekë. Blerësit pranojnë blerjen e objektit të bashkëpronësisë dhe i kanë likuiduar shitësit vlerën tërësore të truallit me mandat të Bankës Kombëtare Tregtare.

120. Subjekti i rivlerësimit, gjatë përgjigjeve të pyetësorit të dërguar nga Komisioni lidhur me dokumentacionin ligjor provues për të provuar burimin financiar, ka paraqitur edhe vendimin nr. ***, nr. *** prot., datë 21.2.2010, për pushim urdhërekzekutimi të ekzekutuar tërësisht nga zyra përmbarimore Tiranë, për arsye të shlyerjes së detyrimit nga pala debitorë “ProCredit Bank” sh.a., në favor të kreditores/bashkëshortes E. M. në shumën 1.427.530 lekë.

121. Në vlerësim të dokumentacionit të përfshirë në deklaratën *Vetting* dhe të dorëzuar në Komision, rezulton se objekti i ndërtuar ka ndërruar destinacion duke përfshirë në të përveç zyrave edhe banesa. Siç konstatohet në certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZRPP-ja Sarandë, datë 23.6.2016, në emër të personit të lidhur Th. M. është regjistruar një apartament me sip. 112 m², një njësi prej 28 m² dhe në bashkëpronësi të pesë personave trualli me sip. 150 m², bazuar kjo ndarje pronësie edhe në deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.6.2016, ndërmjet personave blerës të kësaj prone.

122. Dispozitat ligjore të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, ndalonin organet e pushtetit vendor të tjetërsonin pronat publike.

123. Në nenin 3 të këtij ligji, parashikohej se: “*Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm në rastet që vijojnë: (a) për ndërtimin e banesave me qëllim të lirimimit të banesave të ish-pronarëve, si*

dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti i Banesave apo persona të tjerë; (b) me vendim të Këshillit të Ministrave, për shitje, për investime shumë të rëndësishme për vendin”.

124. Sa më sipër, subjektit rivlerësues iu kërkua me pyetësoin nr. 3 të argumentojë arsyen e ndërrimit të destinacionit të kësaj pasurie në ndryshim nga objekti i përcaktuar në kontratën e lidhur me nr. *, datë 14.8.1996.**

125. Subjekti deklaroi se veprimet e organeve të pushtetit vendor nuk janë përgjegjësi e tij.

126. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara prej tij, duke përfshirë edhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera për këtë pronë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

127. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës shprehet se: *“Ne nuk kemi kryer asnjë veprim të ndaluar nga ligji, unë absolutisht nuk jam pjesë e kësaj situate. Me dokumentet që ju kam vënë në dispozicion kam sqaruar burimet e ligjshme të pasurisë dhe çdo sjellje të prindërve të mi. Nuk ka ndërrim destinacioni, por zgjerim destinacioni dhe përshtatjeje të mjediseve, pa harruar që banimi është nevoja e parë”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

128. Trupi gjykues vlerëson se sipas pikës1, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e pasurisë kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

129. Sipas përkufizimit të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, me pasuri kuptohen të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

130. Në këtë kuptim, çdo pasuri që është deklaruar dhe është në pronësi, posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, në momentin e deklarinimit i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarinimit, si dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit.

131. Referuar përfitimt të kësaj pasurie në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, ku neni 3 i këtij ligji parashikonte se: *“Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm në rastet që vijojnë: (a) për ndërtimin e banesave me qëllim të lirimt të banesave të ish-pronarëve, si dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti i Banesave apo persona të tjerë; (b) me vendim të Këshillit të Ministrave, për shitje, për investime shumë të rëndësishme për vendin”* trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Garazh me sip. 23.8 m², në lagjen nr. *, Sarandë**

132. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “garazh automjeti” me sip. 23.8 m², lagjja nr. ***, rruga “****”, ndërtuar pa leje rreth viteve 1994 - 1995, me burim krijimit të ardhurat nga pagat e dy prindërve, në procedurë legalizimi sipas vetëdeklarinimit formular tip A nr. *** prot., datë 11.11.2006. Vlera totale sipas situacionit të punimeve = 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100% në bashkëpronësi të prindërve.

133. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, depozituar në ILDKPKI, datë 5.10.2012, lidhur me formularin A-1, “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, nuk rezulton e pasqyruar kjo pasuri.

134. Ky ndërtim pa leje, garazh me sip. 31 m², në emër të personit të lidhur Th. M., ndodhur në z. k. ***, nr. pasurie ***, me sip. 752 m², në pronësi të “shtetit”, është objekt i dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

135. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën vjetore periodike të vitit 2012 dhe nuk ka përfshirë në deklaratën *Vetting* kopje të certifikatës së pronësisë për objektin “garazh” dhe për “truallin” ku ndodhet ky objekt.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

136. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Është deklaruar kur është dokumentuar, nuk mund të bëhej ndryshe dhe nuk është bërë/ndërtuar nga unë. Aktet tregojnë se tani vonë është regjistruar. Është prezent në deklarimin e vitit 2018 sipas ligjit, duke qenë se u materializua si pasuri. Nuk ka pasur asnjë tendencë mosdeklarimi, thjesht i jam referuar dokumentimit. Ndërkohë e kam paraqitur rregullisht në deklaratën *Vetting*. Nuk ka asnjë logjikë që mund ta fshehja apo mund ta shmangia. Për më tepër, gjithçka është kryer e proceduar nga im atë dhe nuk mund të gjykoja, vlerësoja, apo kontrolloja veprimet e tij në kuptim të ligjit”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

137. Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 të pandryshuar, sipas germës “a”, të nenit 4, ku objekt deklarimi janë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, ishte i detyruar të deklaronte parcelën ndërtimore, pavarësisht qëndrimit që do të mbante shteti me informalitetin, për shkak të zaptimeve pronësore të individëve. Pavarësisht se subjekti nuk kishte dokumentacion pronësie mbi pasurinë dhe, në pamje të parë dukej sikur do deklaronte pronën e dikujt tjetër (shtetit), të drejtat reale që subjekti kishte realizuar në lidhje me këtë pronë ishin përdorimi dhe banimi, *jus in re aliena*, të drejtat reale mbi sendin e tjetrit. Nisur nga ky parashikim ligjor, subjekti i rivlerësimit duhej ta deklaronte parcelën ndërtimore, pavarësisht mungesës së udhëzimeve dhe mungesës së eksperiencës në deklarime, pasi një detyrim i tillë buronte nga ligji i kohës.

138. Lidhur me deklarimin e subjektit se ky garazh është deklaruar kur është dokumentuar, nuk mund të bëhej ndryshe dhe nuk është bërë/ndërtuar prej tij, gjithçka është kryer e proceduar nga babai i tij dhe nuk mund të gjykonte, vlerësonte, apo kontrollonte veprimet e tij në kuptim të ligjit, pozicionit dhe moralit, si dhe nuk gjendet bindës për trupin gjykues për sa kohë babai i subjektit, referuar hetimit administrativ, nuk dispononte leje drejtimi për automjet.

139. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti, së bashku me provat e tjera në tërësi me rrethanat e çështjes, nuk ishte bindës në shpjegimin e tij për arsyen e mosdeklarimit të këtij garazhi dhe mbi shpjegimet e tij se kjo ishte një pronësi e krijuar nga babai i tij duke mos arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit.

6. Truall me sip. 4.200 m², “*” (***) , Sarandë, individualizuar si pasuritë:**

140. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasuritë nr. ***, sip. 1882,5 m², nr. ***, sip. 1164,7 m², nr. ***, sip. 1153,8 m², me burim kompensimi të pronave të gjyshit A. M. dhe ku personi i lidhur Th. M. si trashëgimtar ligjor i subjektit të shpronësuar A. M. ka në

bashkëpronësi 25% të secilës prej këtyre pronave dhe pjesa tjetër në pronësi po në 25% të 3 vëllezërve të tij.

141. Në DIPP-në e vitit 2004, lidhur me formularin A-1, “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, nuk rezulton e pasqyruar kjo pasuri e personave të lidhur të subjektit rivlerësues. Kjo pasuri nuk është pasqyruar në deklaratën vjetore, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI ndër vite, ndërsa nga ana e personit të lidhur në pozicionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në periudhën 1997 – 2011, u pasqyrua në DIPP-në e vitit 2010.

142. Kjo pronë rrjedh fillimisht nga vendimi nr. ***, datë 1.12.1994, i ish-KKKP-së Sarandë, me anë të të cilit është vendosur njohja e z. A. M. si ish-pronar i këtyre pronave (përkrahur në vendim). Në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, është njohur një sipërfaqe truall prej 4400 m² dhe truall prej 200 m², që është shtëpia, i zbritet nga kompensimi se është kthyer me vendimin nr. ***, datë 22.6.1994. Pikë tjetër e dispozitivit të vendimit nr. ***, datë 1.12.1994, të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Sarandë është që në bazë të germës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, të kompensojë trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarit A. M. me një sipërfaqe truall prej 4200 m², me vendim të veçantë në zonën e re turistike sipas planvendosjes përkatëse.

143. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duhet të provojnë me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, duke depozituar dokumentacionin që vërteton regjistrimin e pronës së kthyer pranë ish-ZRPP-së Sarandë, sipas vendimit nr. ***, datë 22.6.1994, të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Sarandë.

144. Gjithashtu, sipas vendimit nr. ***, datë 18.9.1998, të ish-KKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Sarandë, është i njohur prona ish-pronarit A. M. për truallin me sip. 2600 m² dhe kthyer trashëgimtarëve ligjorë sipërfaqja truall i lirë me sip. prej 960 m², kompensim në natyrë për sipërfaqen prej 1108 m² dhe ushtrimi i të drejtës së parablerjes në rast privatizimi të disa objekteve me sipërfaqe truall nën objekt për sip. 360 m², 127 m² dhe 45 m². Edhe për këtë vendim nuk ka dokument të përditësuar që vërteton regjistrimin e pronës së kthyer dhe nëse është ushtruar e drejta e parablerjes, e drejtë e cila ligjërisht regjistrohet në regjistrat hipotekorë.

145. Ndërkohë, konstatohet se vendimi nr. ***, datë 18.9.1998, ndodhet në formën e shtypur me makinë shkrimi dhe në kompjuter me shënimin “vërtetohet njësia me origjinalin”, nxjerrë nga arkivi, me noter A. M., por nuk janë të njëjtë në përmbajtje të tyre dhe në dispozitivin e vendimit. Ky fakt është konstatuar edhe në korrespondencën zyrtare ndërmjet ZQRPP-së nr. *** prot., datë 8.5.2015, drejtuar ZVRPP-së Sarandë, nr. *** prot., datë 26.3.2015, të ZVRPP-së Sarandë dhe nr. *** prot., datë 30.12.2014, të AKKP-së.

ZQRPP-ja, me shkresat nr. ***, të datave 10.8.2017, 9.10.2017 dhe 12.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Sarandë, e cila konfirmon se shtetasi Th. M. ka të regjistruar në bashkëpronësi me shtetasit F. M., V. M. dhe M. M. (1/4 pjesë secili), pasuritë:

- nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji “truall” me sip. 1882,5 m², z. k. ***, Sarandë;
- nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji “truall” me sip. 1164,7 m², z. k. ***, Sarandë;
- nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji “truall” me sip. 1153,8 m², z. k. ***, Sarandë.

146. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa subjekti i rivlerësimit duhet të paraqesë dokumentin e regjistrimit të pronës së kthyer me vendimin nr. ***, datë 22.6.1994, të ish-KKKP-së pranë Bashkisë Sarandë, nëse është regjistruar e drejta e parablerjes, e drejtë e cila ligjërisht regjistrohet në regjistrat hipotekorë dhe mbi mospërpunueshmërinë e përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 18.9.1998, fakt i konstatuar edhe

nga korrespondenca zyrtare ndërmjet ZQRPP-së nr. *** prot., datë 8.5.2015, drejtuar ZVRPP-së Sarandë nr. *** prot., datë 26.3.2015, të ZVRPP-së Sarandë dhe nr. *** prot., datë 30.12.2014, të AKKP-së.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

147. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: *“Për këtë kam paraqitur dokumentet dhe ju kam sqaruar se deri ku kanë ecur procedurat, nuk është pasuri për të cilën kam proceduar apo kam dijeni konkrete në vazhdimësi, janë situata të trajtuara nga im atë, madje më saktë nga vëllezërit apo të afërmit e tij. Për një pjesë të tyre, im atë madje është vënë vonë në dijeni me sa më ka sqaruar dhe unë kam kërkuar informacion në ZVRPP, nga ku nuk kam pasur në fakt të dhëna të plota jo për fajin tim”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

148. Në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, subjektet e rivlerësimit duhet të rezultojnë shterues në Komision me deklaratimet e tyre, sidomos në deklaratën *Vetting*.

149. Në kuptim të parashikimit të pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

150. Pas analizimit të deklaratimit të subjektit në raport me detyrimin ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë *Vetting*, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë vërtetësinë e deklarimeve dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive.

151. Në këto kushte, situata faktike ku subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të pasurive të mësipërme dhe as nuk ka shpjeguar bindshëm dhe as nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mënyrën e përfitimit të tyre, trupi gjykues vlerëson se situata e subjektit lidhur me deklarin e këtyre pasurive klasifikohet sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë

152. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

152.1. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 69.30 m², zona ***, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë duke u përpjekur të paraqesë një situatë të ndryshme nga ajo faktike, mbështur kjo mbi të gjitha provat dhe faktet e rezultuara gjatë hetimit, e të relatuara më lartë në vendim, e se ai ndodhet në kushtet e germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

152.2. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe duke konsideruar edhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rreme, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të

pasurisë, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

153. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues i tij mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga Prokuroria e Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

154. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Gjatë analizimit të këtij raporti Komisioni ka konstatuar disa problematika që i përkasin dosjeve të përzgjedhura me short referuar në vijim:

Dosja nr. 1

Kallëzimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kjo çështje penale i përket periudhës së dytë të rivlerësimit për subjektin Lorenc Mërkuri në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Nga aktet rezulton se materiali kallëzues me nr. *** është regjistruar mbi bazën e referimit të kryer në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nga oficeri i Policisë Gjyqësore, të Komisarariatit të Policisë Sarandë, A. Gj.. Në referimin e oficerit të policisë gjyqësore parashtrohet fakti se ai ka marrë dijeni nga punonjësi i Bashkisë së Konispolit se dy persona kanë prerë dru në malin Orla dhe i kanë stivosur në vendin e quajtur Rahë. Policia gjyqësore ka shkuar në vendngjarje, ku ka konstatuar drutë e prera dhe të stivosura me përmasa 4x1x1 m, por nuk ka gjetur persona duke punuar. Në vendin e ngjarjes, rreth 15 metra larg, kanë qenë dy shtetas, të cilët kanë shpjeguar se nuk kanë asnjë lidhje me drutë e prera dhe ndodheshin aty për shkak se në afërsi të këtij vendi kanë në pronësi tokat e tyre të mbjella me mandarina. Në këto kushte, oficeri i policisë gjyqësore Sarandë ka referuar rastin në prokurori për veprën penale “prerje e paligjshme e pyjeve” të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Gjatë verifikimit të materialit kallëzues oficeri i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur kryerjen e një aktekspertimi vlerësues, nga i cili ka rezultuar se vlera e drurëve të prerë është në shumën 8.000 lekë.

Në këto kushte, prokurori Lorenc Mërkuri, në mbështetje të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale, më 25.9.2015, ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Të njoftojë me këtë vendim të interesuarin. Kundër këtij vendimi të interesuarit kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë ose tek prokurori më i lartë”*.

Nga aktet e dosjes rezulton se vendimi përfundimtar për mosfillimin e çështjes është marrë në respektim të afatit 30-ditor maksimal, nga momenti i regjistrimit të kallëzimit penal, afat i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, *“Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin*

nr. 241, datë 21.11.2005, 'Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale', i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm.

Rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal i është njoftuar kallëzuesit Sh. Sh., nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2015. Nga aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk rezulton se ky vendim të jetë ankimuar nga kallëzuesi.

Dokumenti ligjor "Vendim mosfillimi" është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese dhe dispozitivi. Në pjesën hyrëse prokurori, subjekt rivlerësimi, përshkruan subjektin vendimmarrës, emërtimin e këtij dokumenti, datën, studimin e akteve të materialit kallëzues në kuadër të të cilit merret ky vendim.

Pjesa arsyetuese është e përbërë nga dy pjesë. Në pjesën e parë, subjekti i rivlerësimit përshkruan regjistrimin e materialit kallëzues nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, mënyrën e njoftimit të veprës penale duke specifikuar marrjen dijani bazuar në referimin e oficerit të policisë gjyqësore. Në pjesën e dytë përshkruan faktin e referuar dhe faktin që rezulton nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit. Në këtë pjesë të vendimit mungon arsyetimi në lidhje me mungesën e të dhënave për elementët e veprës penale "prerje e paligjshme e pyjeve", të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal⁷. Në nenin 38 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" parashikohet se është kundërvajtje administrative prerja pa leje e pyjeve kur pasojat materiale janë të lehta.

Më konkretisht në këtë nen parashikohet se: "... prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80.000 deri në 100.000 lekë". Në pjesën konkluduese, prokurori Lorenc Mërkuri parashtron disponimin e tij duke vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se ka mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsyetuese të vendimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, pasi teksti i vendimit të pushimit të çështjes për këtë procedim penal është i pakuptueshëm.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: "*Prokurori përqendrohet në ekzistencën ose jo të faktit penal dhe jo në përshkrimin e të gjithë kuadrit ligjor tjetër si administrative etj., apo zgjatje të arsytimit në raste të tilla. Në këtë kuptim, arsyetimi i mosfillimit të procedimit penal ka tendencë në këtë drejtim vlerësimi dhe mendoj se kjo është normale, për më tepër nuk ka pasur asnjë lloj pretendimi. Arsyetimi i shkurtër lidhet me faktin tepër formal pa ta dhëna konkrete për ndonjë vepër. Më parë procedohet me kthim aktesh me shkresë, praktikë kjo që po rrallohet*".

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton se pika 3, e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016⁸, por edhe Kodi i Procedurës Penale parashikon se vendimi i prokurorit duhet të jetë i arsyetuar, vendim i cili duhet të përmbajë pjesën hyrëse, arsyetuese dhe dispozitivin e tij.

⁷Në këtë pikë duhet të kihet parasysh fakti që gjatë vitit 2015 prokurori Lorenc Mërkuri ka pasur në ndjekje 246 procedime penale dhe 186 materiale kallëzuese dhe fakti i referuar është i thjeshtë.

⁸Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit.

Qëndrimi i subjektit se vendimi ka qenë për mosfillim nuk do të thotë që të mos jetë i arsyetuar dhe i kuptueshëm nga palët dhe publiku. Prokuroria, si organ procedural ushtron ndjekjen penale dhe, në përmbushje të detyrave të saj kushtetuese⁹, është e detyruar që në përfundim të hetimit të dalë me një vendim të arsyetuar rreth fakteve, provave, ekzistencës apo jo të veprës penale.

Dosja nr. 2

Procedimin penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, datë regjistrimi 8.1.2015, regjistruar për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”, të parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal.

Objekti i shortit: vendim për pushimin e procedimit penal nr.***, viti 2015, datë 30.3.2015.

Ky procedimi penal është regjistruar në bazë të materialeve të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka shpallur moskompetencën tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për çështjen penale të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të nënës së të dëmtuarës M. I..

Më konkretisht, kallëzuesja L. I. është paraqitur më 23.6.2014, në Komisaratin e Policisë nr. *** Tiranë dhe ka parashtruar largimin nga banesa të vajzës së saj të mitur pa deklaruar asnjë adresë. Pas regjistrimit të procedimit penal është gjendur dhe pyetur në shtator të vitit 2014 e mitura M. I., e cila ka deklaruar rrethanat e largimit të saj nga banesa, lidhjen e saj me shtetasin E. K. dhe veprimet e këtij të fundit të shfrytëzimit për prostitucion të kësaj shtetaseje të mitur të kryer në qytetin e Sarandës.

Duke vlerësuar se fakti penal ka ndodhur në rrethin e Sarandës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 27.11.2014, ka shpallur moskompetencën tokësore për hetimin e çështjes penale nr. *** dhe i ka kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Mbi bazën e këtyre akteve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”, parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është regjistruar më parë procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve E. A. T., P. I. B., A. Sh. M., A. Sh. M., R. K. C., E. A. K., të akuzuar për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”, parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal.

Çështja penale nr. ***, në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur, është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.1.2015, ka dënuar shtetasit në fjalë.

Vendimi penal nr. ***, datë 8.1.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është administruar me cilësinë e provës dokumentare në dosjen e procedimit penal nr. ***.

Në rrethanat e lartpërmendura, prokurori Lorenc Mërkuri, brenda afatit hetimor, ka vlerësuar që fakti penal objekt hetimi në çështjen penale nr. ***, përbën “gjë të gjykuar” në kuptim të nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale, i cili sanksionon ndalimin e gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale.

Pas kryerjes së veprimeve të sipërcituara, prokurori Lorenc Mërkuri, subjekt rivlerësimi në mbështetje të neneve 7 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale germa “e” ka vendosur: “*Të pushojë procedimin penal nr. ***, pasi fakti nuk përbën vepër penale. Vendimi t’i njoftohet*

⁹Neni 148 paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

kallëzuesit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë ose tek prokurori më i lartë". Vendimi i është njoftuar kallëzuesit dhe nuk rezultoi se ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Dokumenti ligjor "vendim pushimi" është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën hyrëse, subjekti i rivlerësimit, prokurori Lorenc Mërkuri, përshkruan subjektin vendimmarrës, emërtimin e këtij dokumenti, datën, studimin e akteve të fashikullit të procedimit penal në kuadër të të cilit merret ky vendim, numrin dhe datën e regjistrimit të procedimit penal dhe veprat penale për të cilat është regjistruar.

Pjesa arsyetuese është e përbërë nga tri pjesë. Në pjesën e parë, subjekti i rivlerësimit përshkruan regjistrimin e çështjes penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, mënyrën e njoftimit të veprës penale duke specifikuar marrjen dijeni bazuar në aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në pjesën e dytë përshkruan faktin e kallëzuar dhe faktin që rezultoi nga dokumentacioni i administruar. Në pjesën e tretë arsyetuese prokurori parashtron se në analizë të rrethanave të rezultuara nga hetimi fakti përbën gjë të gjykuar duke analizuar edhe dispozitën përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, si një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale. Në pjesën konkluduese, parashtron disponimin e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe fjalitë janë të qarta. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti është i qartë dhe vendimi është i analizuar drejt. Në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit Penal, si dhe të Kodit të Procedurës Penale ku mbështetet vendimi. Nga pikëpamja e formës, renditja e akteve procedurale pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Trupi gjykues vëren se sipas nenit 47 të Kodit Penal parashikohet mënyra e caktimit të dënimit nga gjykata, ku në caktimin e dënimit ndaj personit, subjekti merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Rrethanat rënduese renditen në nenin 50 të Kodit Penal ku, ndër të tjera, germa "ç" e këtij neni parashikon si rrethanë rënduese kryerjen e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë prezente rrethanën rënduese të të akuzuarit, i cili rezultoi të ishte recidiv/përsëritës, për të njëjtën vepër penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimi, pas kalimi të barrës së provës, shprehet se: *"Referuar vendimit gjyqësor, në rastet kur dispozita parashikon paragraf më vete lidhur me veprimin në rrethana të caktuara dhe që mund të jetë rënduese nuk ka sesi në akuzën për paragrafin ta përfshish, ose do ta paraqesësh si rrethanë rënduese ose si paragraf konkret në dispozitë, nuk mund të jenë të dyja se bien në kontradiktë. Vetë neni 114/2 i Kodit Penal parashikon paragraf më vete në lidhje me veprimin rrethanë rënduese, ndaj nuk mund të referohet neni 50 i Kodit Penal, kjo është praktikë e konsoliduar".*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni vlerëson se neni 50 i Kodit Penal, që ka të bëjë me rrethanat rënduese, është një dispozitë që aplikohet ndaj personit që ka konsumuar veprën penale për të përcaktuar masën e

dënimit. Pra, rrethanat rënduese janë ato që ligjvënësi i ka përcaktuar dhe që organet proceduese duhet t'i marrin parasysh për të aplikuar masën maksimale të dënimit.

Parë në këtë kontekst, prokurori duhet që rrethanat rënduese t'i bëjë me dije në referim të veprës penale dhe t'i ketë parasysh në caktimin e masës së dënimit që kërkon për autorin e veprës penale.

Dosja nr. 3

Procedimi penal nr. ***, datë 18.11.2015, regjistruar për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Vendim për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2015, datë 28.7.2016.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, duke u bazuar në kallëzimin e shtetasit M. Z.. Nga aktet e dosjes rezulton se në datën 15.11.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka bërë kallëzim shtetasi M. Z., për vjedhjen e një karroce që kishte në pronësi të tij, duke shpjeguar se në datën 31.10.2015 ka parkuar automjetin, si dhe karrocën në afërsi të dyqanit të shtetasit R. B.. Pasdite ka shkuar të marrë automjetin dhe karrocën, por nuk e ka gjetur në vendin që e kishte parkuar. Ka pyetur shtetas në afërsi të vendit ku ndodhej e parkuar karroca, por nuk ka mundur ta gjejë. Në këto kushte është paraqitur më 15.11.2015, përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe ka paraqitur kallëzimin e tij.

Në datën 18.11.2015, prokurori Lorenc Mërkuri ka vendosur regjistrimin e procedimit penal dhe me urdhrin e datës 20.11.2015 ka urdhëruar kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale nga oficeri i policisë gjyqësore A. B., duke caktuar edhe kohën e përfundimit të këtyre veprimeve hetimore.

Pas regjistrimit të procedimit penal, më 21.7.2016, është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore kallëzuesi M. Z., i cili ka shpjeguar se karrocën e ka krijuar në mënyrë artizanale. Disa ditë pas kallëzimit, shtetasi S. A. e ka sjellë karrocën në shtëpinë e tij. Ai ka shpjeguar se ky shtetas ia kishte kërkuar karrocën për të kryer disa punë bujqësore, përpara datës në të cilën ka konstatuar mungesën e saj dhe i kishte dhënë leje, por e kishte harruar këtë fakt. Pas mbarimit të punëve bujqësore, shtetasi S. A. e ka kthyer karrocën. Kallëzuesi ka shtuar se kallëzimi ka ndodhur për shkak të një harrese nga ana e tij.

Në këto kushte, pas marrjes së këtij deklarimi, prokurori Lorenc Mërkuri, bazuar në gurmën “b”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 28.7.2016, ka vendosur: “Të pushojë procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, regjistruar për veprën penale të vjedhjes. Vendimi t'i njoftohet personave të interesuar. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ose tek prokurori më i lartë”.

Vendimi i është njoftuar kallëzuesit sipas shkresës me nr. ***, datë 6.9.2016, dhe nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim në gjykatë apo te prokurori më i lartë.

Dokumenti ligjor “Vendim i pushimit të procedimit penal” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese dhe dispozitivi.

Në pjesën hyrëse, subjekti i rivlerësimit, prokurori Lorenc Mërkuri përshkruan subjektin vendimmarrës, emërtimin e këtij dokumenti, datën, studimin e akteve të fashikullit të procedimit penal në kuadër të të cilit merret ky vendim, numrin dhe datën e regjistrimit të procedimit penal dhe veprën penale për të cilën është regjistruar.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e përbërë nga tri pjesë. Në pjesën e parë, subjekti i rivlerësimit përshkruan regjistrimin e çështjes penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, mënyrën e njoftimit të veprës penale duke specifikuar marrjen dijëni, bazuar

në referimin e oficerit të policisë gjyqësore. Në pjesën e dytë përshkruan faktin e kallëzuar dhe faktin që rezulton nga dokumentacioni i administruar. Në pjesën arsyetuese, prokurori parashtron se në analizë të rrethanave të rezultuara nga hetimi fakti nuk përbën veprë penale. Në pjesën konkluduese parashtron disponimin e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit ligjor të mësipërm konstatohet se dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim përgjithësisht të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Teksti është i ndarë në paragrafe dhe fjalitë janë të qarta. Pavarësisht se ka të bëjë me një fakt të thjeshtë, në vendim nuk ka analizë ligjore për mungesën e elementëve të veprës penale. Fashikulli i procedimit penal paraqitet i plotë. Nga pikëpamja e formës, renditja e akteve procedurale pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: *“Në rastin e një fakti të thjeshtë (madje këtu duket fare banal) është logjike që nuk mund të ketë një analizë ligjore aq komplekse dhe të panevojshme, ka vendime shumëfaqëshe, siç ka edhe të tjera më të shkurtër. Nuk duhet anashkaluar edhe ngarkesa e punës sepse përqendrimi i forcave nevojitet më shumë në rastet komplekse, ndaj dhe ligji ndan veprat penale në kategori rëndësie (me një gjyqtar ose me tre)”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues konstaton se arsyetimi i subjektit si më sipër, është i pabazuar në legjislacionin procedural penal. Ligji penal ka bërë klasifikimin e veprave penale, por në asnjë rast nuk ka përcaktuar që për veprat penale, për të cilat ligji parashikon masë të vogël dënimi, prokuroria apo gjykata të mos arsyetojë vendimin.

DENONCIME

156. Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim denoncimet e depozituara nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit. Denoncimet ngrenë pretendime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë proceseve hetimore penale, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm, etj.

156.1. Pasi shqyrtoi secilin denoncim, duke verifikuar edhe dokumentacionin e administruar në dosje lidhur me to, si dhe pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime, Komisioni arrin në përfundimin se për disa prej tyre nuk u vërejtën fakte apo rrethana që mund të përbëjnë *indicie* konkrete për Komisionin dhe që mund të merren në konsideratë në rivlerësimin e subjektit dhe se denoncimet që do të merren në konsideratë janë në vijim:

1. Denoncimet nr. * prot., datë 8.8.2019 dhe nr. *** prot., datë 8.10.2019, të shtetasit V. G.**

Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për aftësitë profesionale, moskryerje hetimesh, shkelje ligjore dhe zvarritje në proces. Gjithashtu shpjegon se ngjitur me pronën e tij të privatizuar është ndërtuar një objekt në mënyrë të kundërligjshme, duke nxjerrë jashtë funksionit objektin e tij. Denoncuesi pretendon se subjekti ka zvarritur për 1 vit kallëzimin e tij dhe në fund e ka pushuar çështjen. Së bashku me denoncimin, ankuesi ka bashkëlidhur edhe vendimin nr. ***, datë 11.1.2018 për “Kundërshtimin e vendimit të vitit 2016, për pushimin e çështjes penale në lidhje me procedimin penal nr. ***”.

Nga verifikimi i ankesave të depozituara nga shtetasi V. G., ka rezultuar se: Denoncuesi ka kallëzuar penalisht pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë shtetasit: J. K. Sh., punonjësit e ALUIZNI-t të Drejtorisë Sarandë, punonjësit e INUV Bashkia Sarandë, punonjësit e Urbanistikës Sarandë, punonjësit e IKMT-së Sarandë dhe punonjësit e IKMT-së

Tiranë. Denoncuesi ka kallëzuar një ndërtim pa leje nga fqinji i tij, shtetasi J. Sh., ndërtim i cili po i shkakton dëm pronës së tij. Kallëzimi penal është regjistruar pranë Prokurorisë Sarandë me nr. procedimi ***. Çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit, i cili me vendimin e datës 1.4.2016, ka vendosur për “Mosfillim të procedimit” në lidhje me materialin kallëzues, regjistruar me nr. ***, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Kallëzuesi/denoncuesi V. G., duke mos qenë dakord me vendimin e prokurorisë e ka ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin nr. ***, datë 11.1.2018, ka vendosur: “Prishjen e vendimit datë 1.4.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë për pushimin e çështjes penale për procedimin penal nr. ***”, duke u urdhëruar organi i akuzës të kryejë veprimet hetimore të përcaktuara në pjesën përshkruese - arsyetuese të këtij vendimi dhe veprime të tjera që do të vlerësohen të nevojshme prej tij brenda një afati 3-mujor nga dita që ky vendim të marrë formë të prerë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. ***, datë 26.3.2018.

Edhe pse gjykata vendosi me vendim gjyqësor të formës së prerë vazhdimin e hetimeve për 3 muaj, ky afat kaloi dhe pas një viti subjekti përsëri doli në konkluzionin për pushimin e çështjes, pa kryer hetime.

Në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barrën e provës të jepte shpjegime për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit mbi gjetjet e evidentuara në trajtimin e këtij denoncimi

Subjekti, ndër të tjera, është shprehur se: “... kam vazhduar hetimet në lidhje me pretendimet e kallëzuesit. Unë kam dhënë dorëheqje. Kam kryer hetimet bazuar në parimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Fakti që gjykata nuk pranon pjesërisht apo tërësisht kërkesën e prokurorit nuk do thotë që unë nuk kam kryer detyrën”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni, në analizë të provave dhe qëndrimit të subjektit në lidhje me procedimin penal nr. ***, konkludoi se subjekti nuk ka kryer hetime dhe nuk ka zbatuar vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 11.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me mosveprimet e tij ka zvarritur çështjen deri sa ka nxjerrë vendimin e pushimit.

Këto mosveprime të subjektit bien në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale¹⁰. Moskryerja e detyrave funksionale të subjektit kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, aftësive organizative të etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenet 73,74 dhe 75, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga denoncuesi, vëren se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore, nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në vendimin e saj në lidhje me hetimet, por e ka zvarritur çështjen tej afateve dhe, në përfundim, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

Si përfundim, nga shqyrtimi në tërësi të këtij denoncimi dhe materialeve bashkëlidhur tij, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka demonstruar minimalisht mangësi të theksuara të njohurive ligjore nëpërmjet rolit të tij pasiv në kryerjen e veprimeve hetimore dhe në funksion të zbardhjes së çështjes. Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen

¹⁰Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 8.2.2018, i shtetasit E. S.**

Denoncuesi denoncon subjektin për mungesë të aftësive profesionale, moskryerje hetimi të dosjes në mënyrë të qëllimshme për të fshehur autorin dhe dhënie të vendimit të padrejtë. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 31.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shënimin: “Mbi ankimin e bërë nga i ndaluari E. S. çështja u shqyrtua nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin nr. ***, datë 3.3.2017, ka vendosur: Pushimin e shqyrtimit të çështjes penale nr. ***, datë 31.1.2017, si dhe akte të tjera të procedimit penal si kërkesa procedurale etj.”.

Nga verifikimi i ankesës së depozituar nga shtetasi E. S. rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte ndaluar shtetasin E. S., si të dyshuar për veprën penale “falsifikim të monedhave”, parashikuar nga neni 183/1 i Kodit Penal. Ndalimi ishte kryer bazuar në kallëzimin e shtetases E. B., shitëse pranë një dyqani celularësh në qytetin e Sarandës. Në datën 20.1.2017, duke shitur në këtë dyqan rreth orës 18:00, është paraqitur një klient i panjohur, rreth 35 vjeç, i cili ka kërkuar të blejë celular tip “Samsung S6 Edgge Plus”. Çmimin e ka paguar në euro duke i dhënë shitëses 500 euro. Pasi është larguar personi shitësja ka dyshuar për pagesën në euro se mund të ishin false dhe ka dalë nga dyqani, ndërkohë personi ishte larguar me një automjet tip “Opel”, ngjyrë të kuqe, me targa ***. Shtetasja E. B. i është drejtuar Policisë, ku dhe ka bërë kallëzimin penal dhe ka treguar rrethanat e ngjarjes në lidhje me personin dhe targat e automjetit tip “Opel”. Nga sistemi *TIMS* në rubrikën “Gjjoba” ky automjet figuronte në emër të shtetasit E. S. i datëlindjes 1981, lindur në Librazhd dhe banues në Durrës, i cili u ndalua së bashku me automjetin e tij. Sipas procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale rezulton se kallëzuesja, pas ndalimit të shtetasit E. S., ka parë duke qarkulluar në qytet një automjet të ngjashëm me atë të personit që i kishte dhënë monedhat false, që kishte targën ***. Në datën 14.2.2017, pas ndjekjes me automjet që kallëzuesja dhe pronari i dyqanit të celulareve i bënë automjetit tip “Opel”, me targa *** dhe me ndihmën e policisë bashkiake kanë arritur të ndalojnë shtetasin M. A. i datëlindjes 1987, lindur dhe banues në Delvinë, i cili rezultoi si autori i vërtetë i veprës penale. Nga materialet e vëna në dispozicion nga denoncuesi vihet re se organi procedues nuk ka kërkuar asnjë provë në lidhje me shitjen e aparatit celular dhe nuk ka kryer gjurmimin e telefonit nëpërmjet numrit IMEI. Shtetasi i ndaluar E. S. ka kryer vetë hetime, ka gjetur prova dhe ka siguruar pamje filmike për të provuar faktin se nuk ishte ai autori i veprës penale. Prokuroi dhe oficeri i policisë nuk kanë kryer asnjë hetim lidhur me objektin e denoncimit nga kjo qytetare sepse shtetasi E. S. nuk ndodhej në vendin e ngjarjes ditën që është kryer vepra penale (për kujtesë: shtetasi E. S. banonte në A. Durrës dhe vepra kishte ndodhur në qytetin e Sarandës).

Komisionit i rezultoi bazuar në provat shkresore të depozituara nga denoncuesi se subjekti nuk kishte ushtruar detyrat e tij funksionale dhe se me veprimet e tij i kishte hequr lirinë një shtetasi të pafajshëm. Në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të shpjegonte rastin e ndalimit/arrestimit të një qytetari të pafajshëm.

Qëndrimi i subjektit mbi gjetjet e evidentuara në trajtimin e këtij denoncimi

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me gjetjet e këtij denoncimi, shprehet se: “Ankesa është jashtë periudhës së rivlerësimit. Dosja nuk është trajtuar nga unë, kam bërë urdhrin e ndalimit dhe kërkesën për masë sigurimi. Impenjimi im ka qenë në të mirë të punës, në seancën e masës është paraqitur prokurori i çështjes, gjykata ka pranuar kërkesën e tij për masën e sigurimit. Nuk arrij të kuptoj pretendimet që ka ankuesi ndaj meje. Rasti ka qenë fatkeq, disa prova që përputheshin dhe denoncuesja njohu mjetin dhe personin (i njëjti mjet, e njëjta ngjyrë, të

njëjtat numra të targës vetëm ndryshimin 567 dhe 576). Besoj çdo prokuror dhe gjyqtar do të vlerësonë në të njëjtën mënyrë, mund të ndodhë në çdo vend të botës. Gabimi i denoncueses ishte njerëzor, dhe më vonë denoncuesja e gjeti dhe denoncoi autorin që është dënuar sipas ligjit. Janë gjëra që ndodhin. Reagimi ka ardhur për faktin se kërkonte dëmshpërblim më shumë sa i takonte. Nuk kam kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin dhe procesin e rregullt. Sjellja ime është mbështetur nga gjykata, ndërkohë që nuk ka bërë kërkesë përjashtimi ndaj meje”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi mori në shqyrtim të gjithë provat materiale, pasi vlerësoi veprimet procedurale të kryera dhe pasi shqyrtoi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë denoncim vlerëson se:

- i) Subjekti ka demonstruar mangësi profesionale në çështjen e mësipërme dhe nuk ka kryer hetim në lidhje me objektin e ngjarjes.
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime procedurale të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes dhe nuk është investuar për një procedim të drejtë bazuar në parimet e Kodit të Procedurës Penale.
- iii) Subjekti i rivlerësimit, për shkak të moskryerjes së hetimeve dhe përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe procedurale, i ka hequr lirinë një qytetari të pafajshëm.

Si përfundim, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi dhe materialeve bashkëlidhur tij, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka demonstruar minimalisht mangësi të theksuara të njohurive ligjore nëpërmjet rolit të tij pasiv në kryerjen e veprimeve hetimore dhe në funksion të zbardhjes së çështjes.

Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit. Rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve të aspekteve ligjore, në kuptim të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratit”.

Këto mosveprime të subjektit kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, aftësitë organizative të etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenet 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 15.10.2018, i shtetasit S. D.**

Denoncuesi pretendon ndaj subjektit të rivlerësimit për shkelje ligjore sepse ka vendosur mosfillimin e një procedimi penal ndaj sipërmarrësit A. Ç., pasi e vlerësoi çështjen për 8 ditë. Çështja u apelua nga denoncuesi dhe u rikthye për hetim. Ndërkohë apelohej dhe nga prokurori i çështjes dhe sërish kthehet për hetim. Sipas denoncuesit deri në datën kur është bërë denoncimi kanë kaluar 880 ditë dhe ende nuk është kryer vlerësimi i çështjes. Denoncuesi ka bashkëlidhur të gjitha kërkesat e bëra prej tij për përjashtim të prokurorit nga çështja, si dhe vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Sarandë dhe Gjirokastrë.

Objekti/përshkrimi i ankesës – nga verifikimi i këtij denoncimi denoncuesi ka kallëzuar sipërmarrësin A. Ç., me objekt “shpërdorim detyre” për moskontrollimin e punimeve gjatë ndërtimit të objektit shumëkatësh të ndërtuar nga ky sipërmarrës.

Palët kanë pasur një marrëdhënie juridiko-civile sipërmarrjeje, sipas së cilës kallëzuesi dhe shtetasi A. Ç. kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e një apartamenti në qytetin e Sarandës. Kallëzuesi ka pasur mosmarrëveshje me sipërmarrësin për punimet në apartament

dhe në datën 23.7.2015 ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë ndaj shtetasit A. Ç.. Me vendimin e datës 31.7.2015, subjekti ka vendosur “Mosfillim të procedimit penal”.

Në datën 18.9.2015, lidhur me këtë vendim u njoftua ankuesi, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin nr. ***, datë 25.11.2015, vendosi pranimin e kërkesës penale të kërkuarit S. D. dhe prishjen e vendimit datë 31.7.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për mosfillimin e procedimit penal duke urdhëruar organin procedues të regjistrojë procedimin penal me materialin kallëzues nr. *** prot., datë 23.7.2015 dhe vazhdimin e hetimeve. Prokuroria e ankimoi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me vendimin nr. ***, datë 15.3.2016, Gjykata e Apelit Gjirokastër vendosi “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”. Denoncuesi, në vazhdimësi, ka paraqitur kërkesë drejtuar prokurorisë, si dhe ka depozituar prova që prokuroria t’i marrë në shqyrtim në lidhje me procedimin penal.

Nga dokumentacioni në dosje nuk rezulton asnjë vendim nga ana e organit procedues në lidhje me këtë procedim se si është ecuria e tij, që janë veprime procedurale të kryera në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë etj. Denoncuesi ka depozituar një sërë kërkesash drejtuar institucioneve të drejtësisë në lidhje me këtë çështje.

Qëndrimi i subjektit mbi gjetjet e evidentuara në trajtimin e këtij denoncimi

Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Ankesa është e pabazuar. Vendimi për mosfillimin e çështjes është marrë brenda afatit ligjor mbi bindjen time të brendshme bazuar në analizën e provave. Në përfundim të hetimeve kam marrë të pandehur sipërmarrësin, shtetasin A. Ç.. Bëhet fjalë për një debat të vlerësimit dhe interpretimit juridik, madje edhe vetë gjykata nuk është konsekuente që tregon se kemi të bëjmë me një cazus të diskutueshëm. Nuk ka pasur asnjë arsye apo shkak ligjor për përjashtimin tim. Kam paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimit të pafajësisë për zënie afati se nuk e kisha vendimin e zbardhur. Ndërkohë, pasi u zbardh vendimi, i pandehuri ka vdekur për shkak të Covid -19. Nuk arrij të kuptoj pretendimet ndaj meje, unë kam vepruar në mënyrë transparente dhe ligjore”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni konstaton se me anë të këtij denoncimi, vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë pa kryer ndonjë hetim ose verifikim dhe se në arsyetimin e prokurorit nuk tregohet nëse neni 290 i Kodit të Procedurës Penale (rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit) dhe vendimi nr. *** i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë marrë parasysh dhe se pretendimet e kallëzimit penal nuk janë sqaruar.

Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se vendimi për mosfillimin e procedimit jepet në mënyrë të arsyetuar¹¹, arsyetim i cili nuk rezulton të jetë bërë nga subjekti.

Subjekti e ka marrë vendim në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 327 e vijues (sipas Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e fundit), ku normohet faza e përfundimit të hetimeve dhe procedimi me dërgimin e vendimit të pushimit në gjykatë. Sipas denoncuesit, nëse prokurori do të kishte kryer hetime, do arrinte një përfundim të ndryshëm nga ato me bazë në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni ka vlerësuar se subjekti me veprimet dhe mosveprimet ka shkelur parimet procedurale¹² për një procedim të drejtë, të barabartë dhe

¹¹Neni 291 vendimi për mosfillimin e procedimit: 1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

¹²Neni 1 i Kodit të Procedurës Penale: *Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.*

të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive personale dhe interesave të ligjshme të shtetasve.

Si përfundim, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi dhe materialeve bashkëlidhur tij, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim.

Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka demonstruar mangësi të theksuara të njohurive ligjore, duke shkelur procedurën e parashikuar në nenin 327 e vijues (sipas Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e fundit) dhe parimet procedurale¹³ për një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor.

Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit. Rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve në drejtim të aspekteve ligjore, në kuptim të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratit”.

Konkluzioni lidhur me aftësitë profesionale

157. Në vlerësimin e trupit gjykues gjetjet dhe mangësitë e konstatuara në dosjet profesionale dhe në dosjet e referuara ngas denoncimet passjellin konkluzionin se subjekti rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën: (i) aftësitë profesionale; (ii) arsyetimin ligjor, shkaqe këto të cilat çojnë në zbatimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

157.1. Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kriteret të cilat urdhërohen të përdoren nga organet e rivlerësimit edhe për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, të vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën, e çojnë trupin gjykues të Komisionit në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka demonstruar gjykim të dobët, që ka sjellë, gjithashtu, shkelje të të drejtave të palëve, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës.

157.2. Në vendimin nr. 2/2017, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 54 të tij citohet: *“Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”*.

157.3 Trupi gjykues vlerëson se ndodhet para rastit kur gabimet e subjektit të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, prandaj

Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale: *“Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimin të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit”*.

¹³Neni 1 i Kodit të Procedurës Penale: *“Legjislati procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtje liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit”*.

Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale: *“Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimin të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit”*.

edhe subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për sa i përket aftësive profesionale sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe mori në shqyrtim të gjitha provat e parashtruara prej tij, konkludon se subjekti:

- a. nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. është i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale për vazhdimin e detyrës së prokurorit;
- c. është konkluduar se sa është arsyetuar lidhur me vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit edhe lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, cenojnë besimin e publikut te drejtësia dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme lidhur me kontrollin e figurës, vlerësimin e pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D dhe pika 4, e nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z.Lorenc Mërkuri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 22.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku